ЗЕЛС
BNJVL

# ГЛАСИЛО
# GAZETË

АПРИЛ / ЈУНИ 2020
PRILL / QERSHOR 2020



ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА **-ЗЕЛС**

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT **-BNJVL**



Почитувани,

Пандемијата со вирусот COVID-19 и преземените мерки во услови на криза во нашата земја создадоа одредени предизвици кои се рефлектираа и во работењето на ЗЕЛС. Донесените мерки за заштита во услови на криза, како што се: забрана за организирање на настани во поголеми групи; одржување на социјална дистанца; самоизолација; работа од дома на ранливи категории граѓани и друго, предизвикаа промени и во начинот на работењето на општинската администрација и на советите. Сето тоа доведе до застој во реализацијата на одредени проекти и на планираните активности. Сепак, како и во целиот свет и ние ги прифативме алтернативни начини за спроведување на дел од активностите, преку користењето на онлајн алатките и електронските платформи за комуникација за одржување на состаноци, работилници, седници и друго.

Во таа насока, Управниот одбор на ЗЕЛС ја одржа тринаесеттата седница на која беа усвоени документи за финансиското работење на ЗЕЛС, но истовремено се говореше и за повторното покренување на иницијативите за продлабочување на процесот на децентрализација; за реперкусиите од намалувањето на приливот на средствата од ДДВ; за недостатокот на градежни инспектори на локално ниво и друго. Седницата се водеше по електронски пат, во согласност со статутарните измени што Генералното собрание на ЗЕЛС ги усвои минатата година. Седница одржа и Генералното собрание - шеста по ред. По електронска пошта на делегатите им беа испратени материјалите за седницата, а тие со пополнување на Изјава, речиси едногласно, ги усвоија сите документи за финансиското работење на ЗЕЛС.

Комисијата за следењето на развојот на финансирањето на општините на онлајн седница ги усвои предлог–уредбите за распределба на приходи од ДДВ и од блок дотациите за локалната власт. Притоа, посочи на потребата за навремено изнаоѓање на соодветни решенија, со цел општините да не бидат доведени во уште подлабока финансиска нестабилност.

Во овој период, ЗЕЛС стана дел од регионалниот проект за јакнење на капацитетите на општинската администрација од одделенијата за социјалната заштита, за адекватно интегрирање на принципот „Никој не смее да биде запоставен" од Агендата 2030, документ на ОН. Втор нов регионален проект, во чие имплементирање, од нашата земја учество зедоа ЗЕЛС и компанијата ПАКОМАК е „Управување со отпад од пакување од стакло во Западен Балкан". Целта на проектот е унапредување на собирањето и соодветен третман на стаклена амбалажа, како и развивање на адекватни бизнис модели применливи во единиците на локална самоуправа.

Во овој период ЗЕЛС презеде активности и со општинските советници, во рамките на проектот „Зајакнување на општинските совети", каде е еден од партнерите. Советниците се вклучија во онлајн дискусиите на актуелни теми за предизвиците од корона кризата во областите на родовата еднаквост, на финансирањето и на урбанизмот.

Со почит,

Душица Перишиќ

Извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Pandemia me virusin COVID-19 dhe masat e ndërmarra në kushte të krizës në vendin tonë krijoi sfida të caktuara që reflektohen edhe ndaj punës së BNJVL-së. Masat e miratuara të mbrojtjes në kushte të krizës, siç janë: ndalimi i organizimit të ngjarjeve në grupe më të mëdha, mbajtja e distancës sociale, vetë-izolimi, punimi nga shtëpia i kategorive të rrezikuara të qytetarëve dhe të tjera, shkaktuan ndryshime edhe në mënyrën e punimit të administratës komunale dhe të këshillave. Të gjitha këto shkaktuan një ngecje në realizimin e projekteve të caktuara dhe aktiviteteve të planifikuara. Megjithatë, si në të gjithë botën, edhe ne pranuam mënyrat alternative për t'u zbatuar një pjesë e aktiviteteve, përmes përdorimit të veglave online dhe platformave elektronike të komunikimit për mbajtjen e mbledhjeve, takimeve, seancave, punëtorive etj.

Në këtë drejtim, Bordi drejtues i BNJVL-së mbajti seancën e tij të trembëdhjetë në të cilën u miratuan dokumente për punën financiare të BNJVL-së, por në të njëjtën kohë u fol edhe për inicim të serishëm të iniciativave për thellim të procesit të decentralizimit; për pasojat nga ulja e të ardhurave të TVSH-së; për mungesën e inspektorëve të ndërtimit në nivel lokal etj. Seanca u zhvillua në mënyrë elektronike, në përputhje me ndryshimet statutore që i miratoi Kuvendi gjeneral i BNJVL-së vitin e kaluar. Seancë mbajti edhe Kuvendi gjeneral, e gjashta me radhë. Materialet për seancë iu dërguan delegatëve në mënyrë elektronike, ndërsa ata me plotësim të një deklarate, gati unanimisht miratuan të gjitha dokumentet për punën financiare të BNJVL-së.

Komisioni për ndjekje të zhvillimit të financimit të komunave në online seancë miratoi propozim-dekretet për shpërndarjen e të ardhurave të TVSH-së si dhe të bllok dotacioneve për pushtetin lokal. Ai gjithashtu theksoi nevojën për gjetje me kohë të zgjidhjeve përkatëse me qëllim që komunat të mos çohen në një situatë të një jostabiliteti edhe më të madh financiar.

Në këtë periudhë, BNJVL-ja u bë pjesë e projektit rajonal për forcim të kapaciteteve të administratës komunale të departamenteve të mbrojtjes sociale për integrim adekuat të parimit "Askush nuk guxon të jetë i anashkaluar" të Agjendës 2020, dokument i OKB-së. Projekti i dytë i ri rajonal, në implementimin e të cilit nga vendi ynë morën pjesë BNJVL-ja dhe kompania "PAKOMAK" është "Menaxhimi i mbeturinave të paketimit të qelqit në Ballkanin Perëndimor". Qëllimi i projektit është avancimi i grumbullimit dhe trajtimit përkatës të ambalazhit të qelqit, si dhe zhvillimi i modeleve adekuate të biznesit që mund të zbatohen në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Në këtë periudhë, BNJVL-ja ndërmerr aktivitete edhe me këshilltarët komunalë, në kuadër të projektit "Përforcimi i këshillave komunalë", ku është një prej partnerëve. Këshilltarët u përfshinë në online diskutimet për tema aktuale për sfidat e krizës me virusin korona në sferat e barazisë gjinore, financimit dhe urbanizmit.

Me respekt,

Dushica Perishiq

Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së

**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија
**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Славе Чорбев
**Лекторирал:** Момент мал ДООЕЛ,Скопје
**Дизајн и подготовка:** СОФИЈА ПРИНТ Богданци
**Печатење:** СОФИЈА ПРИНТ Богданци

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „ Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema - Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska - Dinkovska
**Përkthim:** Sllave Çorbev
**Lektoron:** Moment Mal SHPKNJP, Shkup
**Dizajnim dhe përgatitje:** SOFIJA PRINT Bogdanci
**Shtyp:** SOFIJA PRINT Bogdanci

# ОПШТИНИТЕ АКТИВНИ И ВО УСЛОВИ НА ПАНДЕМИЈА СО ВИРУСОТ COVID-19

# KOMUNAT AKTIVE EDHE NË KUSHTE TË PANDEMISË ME VIRUSIN COVID-19

Пандемијата со корона вирусот и преземените мерки во услови на криза во нашата земја создаде одредени предизвици кои се рефлектираа и во работењето на локалната власт. Донесените мерки за заштита во услови на криза, меѓу кои : забрана за организирање на настани во поголеми групи, одржување на социјална дистанца, самоизолација на дел од граѓаните и друго, предизвикаа промени и во начинот на работењето на општинската администрација и на Советот на општината. Како и во целиот свет и кај нас беа побарани алтернативни начини за спроведување на дел од активностите, особено за одржување на состаноци, средби, седници, работилници, при што масовно се прифати користењето на онлајн алатките и електронските платформи за комуникација. Тоа го сторија и голем број на општини, онаму каде што тоа може да се реализира со користење на ИТ технологијата.

На тој начин општините обезбедија преземање на низа активности за поддршка на населението во заштитата на здравјето; поддршка на социјалните категории на граѓани во услови на криза; како и одредени, дополнителни активности, со кои покрај владините економски мерки, обезбедуваат поддршка на локалната економија. Масовно се вршеше дезинфекција на јавните површини, на влезовите во зградите и во јавните институции; се делеа бесплатни маски за граѓаните; се донираа средства за дезинфекција и за заштитна опрема во здравствени и други установи. Општините организираа и мобилни тимови за обезбедување на намирници и домашна посета на возрасни лица и лица со попреченост. Освен логистичка помош, голем број на општини обезбедуваат и психолошка поддршка, но исто така и парична помош за бројни семејства или граѓани. Од особена важност е што општините се вклучија во обезбедувањето на континуирано ширење на информации кои се важни за заштита на здравјето на граѓаните, како и за справување со настанатата состојба. Речиси сите општини направија прераспределба на средства од одредени поединечни програми и ги насочија за активности за справување со кризата, но исто така, онаму каде имаа услови, обезбедија и поддршка на економските субјекти, преку намалување на одредени давачки за кои е надлежна локалната власт или, пак, одложување на нивното плаќање.

Pandemia me virusin korona dhe masat e ndërmarra në kushte të krizës në vendin tonë krijoi sfida të caktuara që reflektohen edhe ndaj punës së pushtetit lokal. Masat e miratuara të mbrojtjes në kushte të krizës, ndër të cilat: ndalimi i organizimit të ngjarjeve në grupe më të mëdha, mbajtja e distancës sociale, vetë-izolimi i një pjese të qytetarëve dhe të tjera, shkaktuan ndryshime edhe në mënyrën e punimit të administratës komunale dhe të Këshillit të komunës. Si në të gjithë botën, edhe në vendin tonë u kërkuan mënyra alternative për t'u zbatuar një pjesë e aktiviteteve, sidomos për mbajtjen e mbledhjeve, takimeve, seancave, punëtorive, me ç'rast u pranua në mënyrë masive përdorimi i veglave online dhe platformave elektronike të komunikimit. Atë e kanë bërë edhe një numër i madh i komunave, atje ku ajo gjë mund të realizohet me përdorimin e teknologjisë së TI-së.

Në atë mënyrë komunat siguruan ndërmarrjen e një sërë aktivitetesh për të mbështetur popullatën në mbrojtjen e shëndetit, mbështetje për kategoritë sociale të qytetarëve në kushte të krizës, si dhe aktivitete të caktuara shtesë, me të cilat përveç masave qeveritare ekonomike, sigurojnë mbështetje për ekonominë lokale. Bëhej në mënyrë masovike dezinfektimi i sipërfaqeve publike, hyrjeve të ndërtesave dhe institucioneve publike, ndaheshin falas maska për qytetarët, duroheshin mjete për dezinfektim dhe për pajisje mbrojtëse në instituciont shëndetësore dhe institucionet e tjera. Komunat organizuan edhe ekipe mobile për të siguruar ushqime dhe vizita shtëpiake për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara. Përveç ndihmës logjistike, një numër i madh komunash sigurojnë edhe mbështetje psikologjike, por gjithashtu edhe ndihmë me të holla për familje ose qytetarë të shumtë. Është shumë e rëndësishme që komunat iu bashkëngjitën sigurimit të zgjerimit të vazhdueshëm të informacioneve që janë të rëndësishme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, si dhe për ballafaqim me situatën e krijuar. Gati të gjitha komunat kanë bërë rialokim të mjeteve të programeve të caktuara individuale dhe ridestnuan ato për aktivitete për ballafaqim me krizën, por gjithashtu, atje ku kishin kushte, siguruan edhe mbështetje për subjektet ekonomike, duke zvogëluar taksa të caktuara për të cilat është kompetente pushteti lokal ose duke prolonguar pagesën e tyre.





# СОВЕТНИЦИТЕ ДИСКУТИРАА ЗА ПРОМЕНИТЕ КОИ ПРОИЗЛЕГОА ОД КОРОНА КРИЗАТА ВО ОБЛАСТИТЕ НА РОДОВАТА ЕДНАКВОСТ, НА ФИНАНСИРАЊЕТО И НА УРБАНИЗМОТ

Тимот на проектот „Зајакнување на општинските совети" што го имплементира Програмата за развој на Обединетите нации (УНДП), а каде ЗЕЛС е еден од партнерите на проектот, продолжи со реализација на активностите и во услови на пандемија. Па така, во периодот април-јуни, 2020 година, преку ZOOM платформата беа одржани онлајн средби и работилници со општинските советници од трите тематски работни групи: за родова еднаквост; за финансирање и буџет, како и за урбанизам, на теми кои беа непосредно поврзани со промените кои произлегоа од корона кризата. Партнери во проектот што се спроведува со финансиска поддршка на Швајцарската агенција за соработка и развој (СДЦ) се и Здружението на финансиски работници, UN Women, Министерство за локална самоуправа и Министерство за финансии. Проектот е продолжен до октомври 2021 година, односно во следните 18 месеци, почнувајќи од мај 2020 година.

## Улогата на локалната власт во насока на поддршка за справување со случаите на семејно насилство за време на пандемија

Зајакнување на капацитетите на локалната самоуправа за улогата на општината во процесот на справување со случаите на семејно насилство за време на пандемија, беше темата на средбата што во рамките на Проектот „Зајакнување на општинските совети" се одржа на 22 април, 2020 година за членовите на тематската работна група за родова еднаквост. На средбата учествуваа и претседатели/-ките на совети на 24-те партнерски општини и претседатели/-ките на Комисии за еднакви можности од овие општини. Средбата беше организирана од УНДП и ЗЕЛС, со користење на онлајн алатката за комуницирање- ZOOM, а во соработка со UN Women и Националната мрежа против насилство врз жените и семејно насилство. Од оваа средба произлегоа повеќе заклучоци, меѓу кои: 1. Проектот „Зајакнување на општинските совети" да обезбеди адекватно споделување на информации до општините за начините на пријавување семејно насилство, а потоа локалните власти да ги пласираат преку своите веб-портали и социјалните мрежи, за да стигнат што побрзо до најранливите категории граѓани; 2. Да се

# KËSHILLTARËT DISKUTUAN PËR NDRYSHIMET QË DOLËN NGA KORONA KRIZA NË SFERAT E BARAZISË GJINORE , FINANCIMIT DHE URBANIZMIT

Ekipi i projektit "Përforcimi i këshillave komunalë" që e zbaton Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), e ku BNJVL-ja është një nga partnerët e projektit, vazhdoi me realizimin e aktiviteteve edhe në kushte të pandemisë. Kështu, në periudhën prill – qershor 2020, përmes platformës ZOOM u mbajtën online takime dhe punëtori me këshilltarët komunalë të tri grupeve tematike: për barazi gjinore; për financim dhe buxhet, si dhe për urbanizëm, me tema të cilat ishin drejtpërdrejt të lidhura me ndryshimet që dolën nga kriza me virusin korona. Partnerë në projektin që zbatohet me mbështetje financiare të Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SCD) janë edhe Shoqata e punëtorëve financiarë, UN Women, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministria e Financave. Projekti është vazhduar deri në muajin tetor të vitit 2021, përkatësisht në 18 muajt e ardhshëm, duke filluar nga muaji maj i vitit 2020.

## Roli i pushtetit lokal në drejtim të mbështetjes për ballafaqim me rastet e dhunës familjare gjatë pandemisë

Përforcimi i kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për rolin e komunës në procesin e ballafaqimit me rastet e dhunës familjare gjatë pandemisë ishte tema e takimit që në kuadër të projektit "Përforcimi i këshillave komunalë" u mbajt më 22 prill 2020 për anëtarët e grupit punues tematik të barazisë gjinore. Në takim morën pjesë edhe kryetarët/kryetaret e këshillave të 24 komunave partnere dhe kryetarët/kryetaret e Komisioneve të mundësive të barabarta të këtyre komunave. Takimi u organizua nga ana e UNDP-së dhe BNJVL-së, me përdorim të online veglës së komunikimit – ZOOM, e në bashkëpunim me UN Women dhe Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës familjare. Nga ky takim dolën më shumë konkluzione, ndër të cilat: 1. Projekti "Përforcimi i këshillave komunalë" të siguroj shpërndarje adekuate të informacioneve deri te komunat për mënyrat e raportimit të dhunës familjare, e pastaj autoritetet lokale t'i publikojnë nëpërmjet portalet e tyre të internetit dhe rrjeteve sociale që të arrijnë sa më shpejt deri te kategoritë e të ndjeshme të qytetarëve; 2. Të



подобри координацијата и соработка меѓу сите значајни фактори за поуспешно справување со родово базирано насилство на локално ниво; 3. Да се зајакнат административните капацитети на општините кои би спроведувале кампањи, како и други активности кои се покажале како добри практики, а се поврзани со пријавувањето или поддршката на потенцијалните жртви; Да се реализираат обуки на соодветни кадри од општината за процедури и активности кои треба да се преземат за справување со семејно и родово базирано насилство. Државниот секретар на Министерството за труд и социјална политика (МТСП), Јована Тренчевска, ги информираше присутните дека постојат 18 државни сервиси кои моментно се достапни за жртвите на насилство и семејно насилство, кои се отворени од страна на МТСП. Во овој период, многу потенцијални жртви на родово базирано насилство се принудени да бидат „затворени" заедно со насилниците, додека истовремено е намалена достапноста на услугите за поддршка на жртвите. Таа посочи дека ќе се реализира кампања за поттикнување за што поголемо пријавување на семејното насилство во услови на вонредна состојба на COVID-19, бидејќи за жал бројот на пријави во моментот не бележи раст, но постојат наводи за зголемување на бројката на кривични пријави, како и бројката на поплаки поврзани со семејно насилство. Таа информираше дека општините ќе добијат памфлети и видео снимки кои треба соодветно да ги пласираат, за да можат жртвите, но и населението да се информираат каде да се обратат за помош, за поддршка, советување и заштита. Беше изнесено дека зголемување на стапката на семејно насилство бележи пораст во многу земји во светот, меѓу кои: за 30% во Франција и Кипар, за 32% во Сингапур, а пораст е забележан и во Канада, Германија, Шпанија, САД и Велика Британија. Во дискусијата посебно внимание беше посветено на предизвиците што може да ги предизвика ваквата состојба кај девојчињата и кај жените, за што беше заклучено дека е потребно да се преземат системски и законски промени.

## Зголемен бројот на информативни кампањи на локално ниво

Претставничката од УНДП сподели неколку добри искуства применливи на локално ниво: превентивни мерки за информирање; зголемување на капацитетите на центрите за згрижување на жртвите (адаптирање и пренамена на хотелите), изнаоѓање начини и места за полесно пријавување насилство (во аптеки и супермаркети), обезбедување онлајн психо-социјална и правна поддршка, разни кампањи за подигнување на свеста за овој проблем и слично. Од Националната мрежа против насилство врз жени и семејно насилство беше потенцирана потребата за зголемување на активностите од оваа област во руралните средини, каде пристапот до информации и во редовни околности е низок. Претставничката од оваа организација информираше дека поднеле барање до Владата на РСМ за преземање на итни мерки за заштита на жените и децата жртви на семејно насилство, од кои дел се однесуваат и на локалната власт.




përmirësohet koordinimi dhe bashkëpunimi midis të gjithë faktorëve më të rëndësishëm për trajtim më të suksesshëm të dhunës së bazuar gjinore në nivel lokal; 3. Të përforcohen kapacitetet administrative të komunave që do të zbatonin fushata dhe aktivitete të tjera që janë treguar si praktika të mira dhe janë të lidhura me raportimin ose mbështetjen e viktimave potenciale; 4. Të realizohen trajnime të kuadrove përkatëse të komunës për procedura dhe aktivitete që duhet të ndërmerren për ballafaqim me dhunën e bazuar familjare dhe gjinore. Sekretari shtetëror i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), Jovana Trençevska informoi të pranishmit se ka 18 shërbime shtetërore të cilat momentalisht janë në dispozicion për viktimat e dhunës dhe dhunës familjare, që janë hapur nga ana e MPPS-së. Në këtë periudhë, shumë viktima potenciale të dhunës së bazuar gjinore janë të detyruar të jenë "të mbyllur" së bashku me dhunuesit, ndërsa në të njëjtën kohë është zvogëluar disponueshmëria e shërbimeve për mbështetje të viktimave. Ajo theksoi se do të realizohet një fushatë për t'u nxitur raportim sa më të madh të dhunës familjare në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme me virusin COVID-19, sepse për fat të keq numri i raportimeve për momentin nuk shënon rritje dhe ka pretendime për rritje të numrit të kallëzimeve penale dhe numrit të ankesave të lidhura me dhunën familjare. Ajo informoi se komunat do të marrin pamflete dhe video incizime që duhet të publikohen në mënyrë përkatëse me qëllim që të mund viktimat dhe popullata të informohen se ku mund të kërkojnë ndihmë, mbështetje, këshillim dhe mbrojtje. U theksua se rritja e shkallës së dhunës familjare shënon rritje në shumë vende në botë, ndër të cilat: për 30% në Francë dhe Qipro, për 32% në Singapor, ndërsa rritje është shënuar edhe në Kanada, Gjermani, Spanjë, SHBA dhe Britani të Madhe. Në diskutim, një vëmendje më e madhe iu përkushtua sfidave të cilat mund t'i shkaktojë kjo gjendje te vajzat dhe femrat, për të cilën gjë u konkludua se ka nevojë të ndërmerren ndryshime sistemore dhe ligjore.

## Është rritur numri i fushatave informative në nivel lokal

Përfaqësuesja e UNDP-së ndau disa përvoja të mira që mund të zbatohen në nivel lokal: masa preventive për informim, rritje të kapaciteteve të qendrave për përkujdesje të viktimave (adaptim dhe konvertim i hoteleve), gjetje të mënyrave dhe vendeve për raportim më të lehtë të dhunës (në barnatore dhe supermerkete), sigurim të një online mbështetjeje psiko-sociale dhe juridike, fushata të ndryshme për ngritje të vetëdijes për këtë problem dhe e ngjashme. Nga Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës familjare u theksua nevoja për rritje të aktiviteteve të kësaj sfere në mjediset rurale, ku qasja deri te informacionet edhe në rrethana të rregullta është e ulët. Përfaqësuesja e kësaj organizate informoi se kanë parashtruar kërkesë deri te Qeveria e RMV-së për ndërmarrje të masave urgjente për mbrojtje të femrave dhe fëmijëve viktima të dhunës familjare, një pjesë prej të cilave kanë të bëjnë edhe me pushtetin lokal.



Претседателките на општинските совети посочија на пораст на бројот на информативни кампањи за спречување на семејното насилство на локално ниво, што се реализираат во соработка со невладините организации и искажаа подготвеност за лично вклучување во превенцијата на ваквите состојби. Беше изнесена и потребата за поголема соработка на комисиите за родова еднаквост од општините во работата на Центрите за социјални работи, на Министерство за внатрешни работи, како и кај невладиниот сектор, за што е потребна и дополнителна едукација во насока на поефикасно спроведување на соработката и на мерките.

Kryetaret e këshillave komunalë theksuan rritjen e numrit të fushatave informative për parandalim të dhunës familjare në nivel lokal që realizohen në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shprehën gatishmëri për përfshirjen e tyre personale në parandalimin e gjendjeve të këtilla. U theksua edhe nevoja për bashkëpunim më të madh të komisioneve të barazisë gjinore të komunave, Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe te sektori joqeveritar në punën e Qendrave të punëve sociale, për të cilën gjë ka nevojë për një edukim shtesë në drejtim të zbatimit më efikas të bashkëpunimit të masave.

## ЗЕЛС ДЕЛ ОД РЕГИОНАЛНИОТ ПРОЕКТ ЗА АДЕКВАТНО ИНТЕГРИРАЊЕ НА ПРИНЦИПОТ „НИКОЈ НЕ СМЕЕ ДА БИДЕ ЗАПОСТАВЕН“ ОД АГЕНДАТА 2030

## BNJVL-JA PJESË E PROJEKTIT RAJONAL PËR INTEGRIM ADEKUAT TË PARIMIT "ASKUSH NUK GUXON TË JETË I ANASHKALUAR" TË AGJENDËS 2030

Заедницата на единиците на локалната самоуправа на Република Северна Македонија- ЗЕЛС до крајот на 2022 година активно ќе учествува во реализација на регионалниот проект чија цел е општините успешно да ги планираат и спроведуваат активностите кои ќе придонесат за адекватно интегрирање на принципот „Никој не смее да биде запоставен", што произлегува од Агенда 2030, документ на ОН. Овој документ содржи 17 цели за одржлив развој и истиот е усвоен од страна на сите земји членки на ОН. Преку реализација на предвидените проектни активности ЗЕЛС ќе обезбеди јакнење на капацитетите на општинската администрација од одделенијата за социјалната заштита, во насока на соодветна примена на веќе потврдени, успешни модели за подобри социјални, економски и културни човекови права на социјално исклучените категории на граѓани.

Во овој регионален проект, што го финансира ГИЗ, а го имплементира НАЛАС - Мрежата на асоцијациите на единиците на локални самоуправи од земјите од Југоисточна Европа, освен ЗЕЛС учествуваат и асоцијациите на: Албанија, Босна и Херцеговина, Косово и Србија. Проектот треба да придонесе за подобра примена на модулот „Социјални права за исклучените групи 2", со фокус на споделувањето на успешните модели за социјална инклузија и развој и примена на методологијата за социјално мапирање за подобро планирање и одлучување на локално ниво.

### Можности за примена на добри искуства на локално ниво за социјалната интеграција на исклучените групи на граѓани

Дефинираните активности вклучуваат поставување на институционална структура за имплементација на проектот, потоа идентификување, документирање и надградување на петте модели кои произлегуваат од претходно реализираниот проект „Социјални права за исклучените групи 1", како и развивање и спроведување на обуки за секој од дадените модели. Активности ќе има и за поддршка низ процесот на примена на социјалното мапирање во општините, применувајќи го принципот на собирање на разделени податоци за исклучените групи на граѓани. Тие податоци ќе се користат во понатамошно планирање за социјална интеграција на оваа категорија на граѓани.

Поконкретно, во рамките на проектот секоја земја ќе примени по еден од утврдените пет модели : 1.Подигнување на свеста

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut – BNJVL deri në fund të vitit 2022 do të marrë pjesë në mënyrë aktive në realizimin e projektit rajonal, qëllimi i të cilit është që komunat t'i planifikojnë dhe zbatojnë në mënyrë të suksesshme aktivitetet që do të kontribuojnë për integrim adekuat të parimit "Askush nuk guxon të jetë i anashkaluar" që del nga Agjenda 2030, dokument i OKB-së. Ky dokument përmban 17 qëllime për zhvillim të qëndrueshëm dhe i njëjti është miratuar nga ana e të gjitha vendeve anëtare të OKB-së. Përmes realizimit të aktiviteteve të parapara të projektit, BNJVL-ja do të sigurojë forcimin e kapaciteteve të administratës komunale të departamenteve të mbrojtjes sociale në drejtim të zbatimit përkatës të modeleve tashmë të konfirmuara dhe të suksesshme për të drejta më të mira sociale, ekonomike dhe kulturore njerëzore të kategorive të përjashtuara sociale të qytetarëve.

Në këtë projekt rajonal që financohet nga GIZ-i dhe zbatohet nga NALAS-i – Rrjeti i asociacioneve të njësive të vetëqeverisjeve lokale të vendeve të Evropës Juglindore, përveç BNJVL-së marrin pjesë edhe asociacionet e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës dhe Serbisë. Projekti duhet të kontribuojë për zbatim më të mirë të modulit "Të drejtat sociale për grupet e përjashtuara 2", që fokusohet në ndarjen e modeleve të suksesshme për përfshirje sociale dhe zhvillim dhe zbatim të metodologjisë së mapimit social për planifikim dhe vendimmarrje më të mirë në nivel lokal.

### Mundësi për zbatim të përvojave të mira në nivel lokal për integrimin social të grupeve të përjashtuara të qytetarëve

Aktivitetet e përcaktuara përfshijnë krijimin e një strukture institucionale për zbatimin e projektit, pastaj identifikimin, dokumentimin dhe përmirësimin e pesë modeleve që dalin nga projekti i realizuar më parë "Të drejtat sociale për grupet e përjashtuara 1", si dhe zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve për secilin nga modelet e dhëna. Do të ketë aktivitete edhe për të mbështetur procesin e zbatimit të mapimit social në komuna, duke zbatuar parimin e mbledhjes së të dhënave të ndara për grupet e përjashtuara të qytetarëve. Këto të dhëna do të përdoren në planifikimin e mëtutjeshëm për integrimin shoqëror të kësaj kategorie të qytetarëve.

Më konkretisht, në kuadër të projektit çdo vend do të zbatojë nga një prej pesë modeleve të përcaktuara: 1. Ngritja e vetëdijes

(Awareness Raising); 2.Мобилни тимови за поддршка на ранливите категории на лица (Mobile Outreach Teams); 3.Центри за дневна грижа (Day Care Centers); 4.Форум за социјален дијалог ( Social Dialogue Forum ) и 5.Управување и справување со ризик од катастрофа (Emergency Responses and Disaster Risk Management).

ЗЕЛС ќе го применува четвртиот модел „Форум за социјален дијалог " каде ќе бидат искористени добрите практики од Косово, кои произлегоа од првата фаза од проект „Социјални права за исклучените групи 1". Притоа ќе бидат реализирани активности што се однесуваат на јакнење на капацитетите на општинската администрација, ќе се обезбеди поставување на кластери за учење, а општините ќе добијат поддршка при имплементирањето на моделите, како и поддршка за документирање на најдобрите практики. Во согласност со проектот, ЗЕЛС ќе објави јавен повик за интерес на општините за вклучување во проектните активности, со прецизно утврдени критериуми за пријавување, по што ќе бидат избарани најмногу 20 претставници од локалната власт и од ЗЕЛС. Секоја од земјите учеснички во проектот може да ги применуваат сите модели и добри пракси за останатите општини, со што ќе се обезбеди одржливост на проектот. ЗЕЛС, во месец мај, започна со подготовките за започнување на активностите од овој проект.

(Awareness Raising); 2. Ekipet mobile për mbështetje të kategorive të ndjeshme të njerëzve (Mobile Outreach Teams); 3. Qendrat e kujdesit ditor (Day Care Centers); 4. Forumi i dialogut social ( Social Dialogue Forum) dhe 5. Menaxhimi dhe tejkalimi i rrezikut të katastrofës (Emergency Responses and Disaster Risk Management).

BNJVL-ja do ta zbatojë modelin e katërt "Forumi i dialogut social" ku do të përdoren praktikat e mira të Kosovës, të cilat dolën nga faza e parë e projektit "Të drejtat sociale për grupet e përjashtuara 1". Gjithashtu do të realizohen aktivitete që kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve të administratës komunale, do të sigurohet vendosja e klasterëve të të mësuarit, ndërsa komunat do të marrin mbështetje gjatë implementimit të modeleve, si dhe mbështetje për t'i dokumentuar praktikat më të mira. Në përputhje me projektin, BNJVL-ja do të shpallë një thirrje publike për interesin e komunave për t'u përfshirë në aktivitetet e projektit, me kritere të përcaktuara saktësisht për paraqitje, kështu që do të zgjidhen më së shumti 20 përfaqësues të pushtetit lokal dhe të BNJVL-së. Secili nga vendet pjesëmarrëse në projekt mund t'i zbatojë të gjitha modelet dhe praktikat e mira për komunat e tjera me ç'rast do të sigurohet një qëndrueshmëri e projektit. BNJVL-ja në muajin maj filloi përgatitjet për t'i filluar aktivitetet e këtij projekti.

## ПРЕДИЗВИЦИТЕ СО ОПШТИНСКИТЕ БУЏЕТИ И АДМИНИСТРИРАЊЕТО СО ЛОКАЛНИТЕ ДАНОЦИ И ТАКСИ, ВО УСЛОВИ НА КРИЗАТА, ТЕМА НА ДИСКУСИЈА КАЈ СОВЕТНИЦИТЕ

Советниците, членови на тематската работна група за финансирање и буџет и претседателите на советите од 24-те партнерски општини на 12 мај, 2020 година, во рамките на Проектот „Зајакнување на општинските совети", преку ZOOM платформата дискутираа за предизвиците на единиците на локалната самоуправа, за општинските буџети, како и за администрирањето со локалните даноци и такси, во услови на кризата со вирусот КОВИД -19.

## SIDAT ME BUXHETET KOMUNALE DHE ADMINISTRIMIN E TATIMEVE DHE TAKSAVE LOKALE, NË KUSHTE TË KRIZËS, TEMË E DISKUTIMIT TË KËSHILLËTARËVE

Këshilltarët, anëtarë të grupit tematik punues për financim dhe buxhet dhe kryetarët e këshillave të 24 komunave partnere më 12 maj 2020, në kuadër të projektit "Përforcimi i këshillave komunalë", përmes platformës ZOOM diskutuan për sfidat e njësive të vetëqeverisjes lokale me buxhetet komunale, si dhe me administrimin e tatimeve dhe taksave lokale në kushte të krizës me virusin COVID-19. Në fillim të takimit, fokusi u vu te Dekreti me



На почетокот на средбата фокусот беше ставен на: Уредбата со законска сила за примена на Законот за буџетите за време на вонредна состојба (Службен весник на РСМ бр. 79/20) како и Уредбата со законска сила за примена на Законот за локална самоуправа за време на вонредна состојба (Службен весник на РСМ бр. 84/20, 95/20) донесени од Владата на РСМ, кои имаат директно влијание врз Законот за буџетите; Законот за локална самоуправа и Законот за финансирање на единиците на локалната самоуправа. Проф. д-р Марина Трпеска говореше за предизвиците кои неминовно се појавуваат како резултат на донесените уредби, како што е одложеното донесување на фискалната стратегија додека трае пандемијата, што би можело да влијае на подготовката на буџетскиот циркулар и неговото доставување до ЕЛС, но и да предизвика доцнења во донесувањето на буџетите на ЕЛС за 2021 година. Како предизвик беше посочена и прераспределбата на буџетските средства. Имено, со новите владини уредби, при прераспределба на средства од една програма во друга, дозволено е таа прераспределба да биде до максимум 70% од вкупните средства предвидени за таа програма. Проф. д-р Трпеска истакна дека одлуката за износот и одлуката од која програма ќе се врши прераспределбата на средствата зависи од потребите на секоја општина поединечно, и истата ја носи Советот на општината. Особено значајна беше и дискусијата околу подготовката на буџетот и програмите за 2021 година ,ако се има предвид ограничувањето од 30% на реализираност на буџетот од претходната година, во услови кога поради вонредната состојба се очекува (веројатна) ниска стапка на реализација во 2020 година, намалени приходи на општините, намален износ на ДДВ, а се очекува и севкупна рецесија.

## Советниците изнесоа искуства како општините се справуваат со предизвиците од корона вирусот

Присутните претставници од општинските совети пренесоа одредени искуства за гтоакако се справуваат со предизвиците во овој период. Претседателот на Советот на Општина Велес, Ненад Коциќ, посочи дека во Општина Велес се прави прераспределба на средства од одредени поединечни програми. Тој го изнесе и мислењето за потребата за поддршка на економските субјекти во услови на криза, преку намалување

fuqi ligjore për zbatim të Ligjit për buxhetet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 79/20) si dhe Dekreti me fuqi ligjore për zbatim të Ligjit për vetëqeverisje lokale gjatë gjendjes së jashtëzakonshme (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 84/20, 95/20) të miratuara nga Qeveria e RMV-së, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë ndaj Ligjit për buxhetet, Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Prof. d-r. Marina Tërpeska foli për sfidat të cilat paraqiten pa dyshim si rezultat i dekreteve të miratuara, siç është miratimi i prolonguar i strategjisë fiskale derisa zgjat pandemia, që do të mund të ndikonte ndaj përgatitjes së cirkularit buxhetor dhe dërgimit të tij deri te NJVL-të, por edhe të shkaktojë vonesa në miratimin e buxheteve të NJVL-ve për vitin 2021. Si sfidë u theksua edhe rialokimi i mjeteve buxhetore. Në fakt, me dekretet e reja qeveritare, gjatë rialoikimit të mjeteve të një programi në një program tjetër, është lejuar që ai rialokim të jetë maksimum deri më 70% të mjeteve totale të parapara për atë program. Prof. d-r. Tërpeska theksoi se vendimi për shumën dhe vendimi nga i cili program do të kryhet rialokimi i mjeteve varet nga nevojat e çdo komune veç e veç, dhe të njëjtin e miraton Këshilli i komunës. Sidomos i rëndësishëm ishte edhe diskutimi për përgatitjen e buxhetit dhe programeve për vitin 2021, nëse merret parasysh kufizimi prej 30% të realizimit të buxhetit të vitit të kaluar, në kushte kur për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme pritet që shkalla e realizimit në vitin 2020 të jetë e ulët, të ulen të ardhurat e komunave, të ulet shuma e TVSH-së dhe të ketë një recesion total.

## Këshilltarët prezantuan përvoja se si komunat ballafaqohen me sfidat e virusit korona

Përfaqësuesit e pranishëm të këshillave komunalë transferuan përvoja të caktuara se si ballafaqohen me sfidat në këtë periudhë. Kryetari i Këshillit të Komunës së Velesit, Nenad Kociq theksoi se në Komunën e Velesit bëhet rialokim i mjeteve të programeve të caktuara individuale. Ai shprehu edhe mendimin se ka nevojë për mbështetje të subjekteve ekonomike në kushte të krizës, me zvogëlim të



на одредени давачки за кои е надлежна локалната власт или, пак, одложување на нивното плаќање. Ристо Сакалиев, претседател на Совет на Општина Кавадарци, посочи дека во Општина Кавадарци било извршено намалување за 50% на средствата од програмата за култура и спорт и нивно прераспределување кон програмите за социјална заштита и комунална инфраструктура. Оваа мерка е предвидена како привремена, бидејќи очекуваат истите средства да ги враќаат со средства заштедени од јавните наддавања при спроведувањето на јавните набавки. Бесим Мемеди, претседател на Советот на Општина Гостивар, ја сподели загриженоста за неможноста да се направи ребаланс на буџетот, бидејќи Советот не одржал ниту една седница од прогласувањето на вонредната состојба. Тој нагласи дека седницата на Советот е закажана за 20 мај 2020 година и дека тоа може да предизвика доцнења во донесувањето на буџетот на општината и годишната сметка, иако рокот со Уредбата е одложен за два месеца, односно до 30 мај 2020. Проф. д-р Трпеска предложи разгледување на сите можности и усогласување на ставовите пред седницата на Советот, кога истите би се усвоиле.

## Потребно е подобрување на слабостите во регулативата за локалните даноци

Славко Лазовски, експерт за даночни прашања, во својата презентација информираше дека во однос на даноците и таксите не е донесена ниту една уредба која би влијаела на нивното извршување. Тој појасни дека тие се таканаречени „бавни даноци" кои се собираат во текот на целата година, и дека најголем раст на приходите има во четвртото тромесечје и треба да се очекува нивно остварување. Но, според него, оваа состојба сепак покажа дека постојат многу слабости во регулативата за локалните даноци кои треба соодветно да се адресираат за да се надминат. Лазовски укажа дека од фискален аспект општините немаат големи надлежности и простор за преземање мерки, бидејќи во земјава не постои фискален паралелизам. Според него, постои недостаток во делокругот на надзорот, поточно не постои централен орган за надзор, со што општините, односно градоначалниците се обврзани да дадат посебни овластувања на претставници на општинската администрација да вршат надзор. Беше посочено и на слабата ефикасност на општините во собирањето на даноците, при што постојните ресурси не се користат максимално. Тој посочи на одредени области каде општината може да постигне подобрување, преку: забрзување на администрирање на даночните решенија, подобрување во фискалниот катастар, воведување на даночно поштенско сандаче и други мерки и активности.

На крајот од средбата беа донесени следниве заклучоци: 1.Проектот да продолжи со обезбедување на стручна помош до општинските совети во извршување на нивните надлежности од областа на локални јавни финансии во услови на пандемија; 2.Преговорите меѓу претставниците на централната и локалната власт да се иницираат пред започнување на процесот на буџетирање за 2021 година, со цел разгледување на предизвиците и потребите на општините и заедничко изнаоѓање на најсоодветни решенија и 3.Општините да се ангажираат за поголемо користење на ИКТ алатките за интеракција со граѓаните при процесот на подготовка на буџетот за 2021 година, како и за зголемување на бројот на електронските услуги, вклучително и издавањето на решенијата за данок на имот.

tatimeve të caktuara për të cilat është kompetent pushteti lokal ose prolongim të pagesës së tyre. Risto Sakaliev, kryetar i Këshillit të Komunës së Kavadarit, theksoi se në Komunën e Kavadarit është bërë zvogëlim për 50% i mjeteve të programit të kulturës dhe sportit dhe alokim i tyre drejt programeve të mbrojtjes sociale dhe infrastrukturës komunale. Kjo masë është paraparë si e përkohshme sepse ata presin t'i kthejnë mjetet e njëjta me mjete të kursyera nga ankandet publike gjatë zbatimit të prokurimeve publike. Besim Memedi, kryetar i Këshillit të Komunës së Gostivarit, ndau brengosjen e tij për pamundësinë që të bëhet rebalanc i buxhetit, sepse këshilli nuk ka mbajtur asnjë seancë që nga shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme. Ai theksoi se seanca e Këshillit u caktua për 20 maj 2020 dhe se ajo mund të shkaktojë vonesa në miratimin e buxhetit të komunës dhe llogarisë vjetore, edhe pse afati është prolonguar me dekret për dy muaj, përkatësisht deri më 30 maj 2020. Prof. d-r. Tërpeska propozoi të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe të harmonizohen qëndrimet para seancës së Këshillit, kur do të miratoheshin të njëjtat.

## Nevojitet të përmirësohen dobësitë në rregulloren për tatimet lokale

Sllavko Llazovski, ekspert për çështje tatimore, në prezantimin e tij informoi se lidhur me tatimet dhe taksat nuk është miratuar asnjë dekret që do të ndikonte ndaj ekzekutimit të tatimeve dhe taksave në nivel lokal. Ai shpjegoi se ato janë të ashtuquajtura "tatime të ngadalshme" që grumbullohen gjatë gjithë vitit dhe se rritje më të madhe të të ardhurave ka në tremujorin e katërt dhe duhet të pritet që ato të realizohen. Por, sipas tij, kjo gjendje megjithatë tregoi se ka shumë dobësi në rregulloren e tatimeve lokale që duhet të adresohen në mënyrë përkatëse që të tejkalohen. Llazovski theksoi se nga aspekti fiskal, komunat nuk kanë kompetenca të mëdha dhe hapësirë për të ndërmarrë masa, sepse në vend nuk ka paralelizëm fiskal. Sipas tij, ka mungesë në sferën e mbikëqyrjes, më saktësisht nuk ka një organ qendror për mbikëqyrje, me ç'rast komunat, përkatësisht kryetarët e komunave janë të detyruar të japin autorizime të veçanta për përfaqësuesit e administratës komunale për të bërë mbikëqyrje. U theksua edhe efikasiteti i dobët i komunave në arkëtimin e mjeteve të tatimeve, kështu që resurset ekzistuese nuk përdoren maksimalisht. Ai theksoi sfera të caktuara ku komuna mund të arrijë përmirësim, përmes përshpejtimit të administrimit të vendimeve tatimore, përmirësimit të kadastrës fiskale, aplikimit të kutisë tatimore postare dhe masave dhe aktiviteteve të tjera.

Në fund të takimit u morën këto konkluzione: 1. Projekti të vazhdojë me sigurim të ndihmës profesionale për këshillat komunalë në kryerjen e kompetencave të tyre të sferës së financave lokale publike në kushte të pandemisë; 2. Negociatat ndërmjet përfaqësuesve të pushtetit qendror dhe lokal të iniciohen para se të fillojë procesi i buxhetimit për vitin 2021 me qëllim që të shqyrtohen sfidat dhe nevojat e komunave dhe të gjenden bashkërisht zgjidhjet më adekuate dhe 3. Komunat të angazhohen për përdorim më të madh të veglave të TUK-ut për interaksion me qytetarët gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit për vitin 2021, si dhe për rritje të numrit të shërbimeve elektronike, duke përfshirë edhe lëshimin e vendimeve për tatimin e pronës.

# „УПРАВУВАЊЕ СО ОТПАД ОД ПАКУВАЊЕ ОД СТАКЛО ВО ЗАПАДЕН БАЛКАН" Е НОВИОТ РЕГИОНАЛЕН ПРОЕКТ ШТО СЕ ИМПЛЕМЕНТИРА ВО ПАРТНЕРСТВО СО ЗЕЛС

ЗЕЛС, во соработка со Германското друштво за интернационална соработка (ГИЗ), е партнер во имплементација на проектот „Управување со отпад од пакување од стакло во Западен Балкан", финансиран од Сојузното министерство за економска соработка и развој на Германија (BMZ) и компанијата ПАКОМАК (Македонија), во рамки на програмата за соработка со бизнис секторот develoPPP.de. Оваа програма (DeveloPPP.de) на Германското сојузно министерство за соработка и развој е насочена кон градење и развој на соработка меѓу јавниот и приватен сектор на локално ниво. Целта на проектот е унапредување на собирање и соодветен третман на стаклена амбалажа, како и развивање на адекватни бизнис модели применливи во единиците на локална самоуправа. Поконкретно, ќе се овозможат услови за развивање на мрежа за собирање на стаклена амбалажа со поставување на соодветна инфраструктура и подобрување на достапноста на услугите и на информациите за правилна примарна селекција.

Проектот е во времетраење од 30 месеци, почнувајќи од 15 февруари, 2020 година и истовремено се спроведува и во: Босна и Херцеговина (Екопак и РЕДАХ) и во Србија (Секопак и НАЛЕД). Предмет на активностите се: изработка на анализа за унапредување на постоечките системи на управување со стаклена амбалажа и можности за воведување депозит; изработка на модел за собирање и рециклирање на стаклена амбалажа според видот на општината (урбана, рурална); пилотирање на моделот преку набавка на опрема (контејнери за собирање стаклена амбалажа); обука за јавните комунални претпријатија и тркалезни маси за компании; кампања за подигнување на свеста за граѓаните и изработка на бизнис модел за натамошен развој на инфраструктура за рециклирање на стакло. Од особена важност е промовирањето на значењето на примарната селекција и рециклажата, во насока на подигање на свеста кај граѓаните за полезноста од овие процеси кои придонесуваат за заштитата на животната средина, за подобрување на здравјето на луѓето и кои обезбедуваат економска полезност за сите.

## Формирана Работна група за имплементирање на проектните активности

Задницата на единиците на локалната самоуправа – ЗЕЛС, на 8 јуни, 2020 година, преку видео конференциска платформа го одржа првиот воведен состанок на Работната група за имплементирање на активностите на проектот „Управување со стаклена амбалажа на Западен Балкан". Целта на Работната група е воспоставување дијалог на засегнатите страни во градењето пристап и политики заради создавање успешен, квалитетен, ефикасен и применлив модел за собирање и рециклирање стаклена амбалажа од страна на единиците на локалната самоуправа. Профилот на членовите на Работната група (претставници на локалната самоуправа, на министерства, невладиниот сектор и на стопанските комори) е во насока на поставување на оптимални модели за собирање, транспорт и рециклирање на пакувања од стакло, кои би биле локално (јавно), еколошки и економски исплатливи за примена. Работната група брои 15 члена.

# "MENAXHIMI I MBETURINAVE TË PAKETIMIT TË QELQIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR" ËSHTË PROJEKTI I RI RAJONAL QË IMPLEMENTOHET NË PARTNERITET ME BNJVL

BNJVL-ja në bashkëpunim me Shoqatën gjermane për bashkëpunim internacional (GIZ) është partner në implementimin e projektit "Menaxhimi i mbeturinave të paketimit të qelqit në Ballkanin Perëndimor", të financuar nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit e Gjermanisë (BMZ) dhe kompania PAKOMAK (Maqedoni), në kuadër të programit të bashkëpunimit me sektorin e biznesit develoPPP.de. Ky program (DeveloPPP.de) i Ministrisë Federale Gjermane të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit është fokusuar drejt ndërtimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit midis sektorit publik dhe atij privat në nivel lokal. Qëllimi i projektit është avancimi i grumbullimit dhe trajtimit adekuat të ambalazhit të qelqit, si dhe zhvillimi i modeleve adekuate të biznesit që mund të zbatohen në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Më konkretisht, do të mundësohen kushte për zhvillim të rrjetit të grumbullimit të ambalazhit të qelqit me vendosjen e një infrastrukture përkatëse dhe përmirësimin e disponueshmërisë së shërbimeve dhe informacioneve për selektim të drejtë primar.

Projekti do të zgjasë 30 muaj, duke filluar nga 15 shkurti 2020 dhe zbatohet në të njëjtën kohë edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë (Ekopak dhe REDAX) dhe në Serbi (Sekopak dhe NALED). Objekti i aktiviteteve janë: përgatitja e një analize për avancimin e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të ambalazhit të qelqit dhe mundësi për aplikim të depozitës; përpilimi i një modeli të grumbullimit dhe riciklimit të ambalazhit të qelqit sipas llojit të komunës (urbane, rurale); pilotimi i modelit përmes furnizimit të pajisjes (kontejnerë për grumbullim të ambalazhit të qelqit); trajnimi për ndërmarrjet publike komunale dhe tryeza të rrumbullakëta për kompani; fushata për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe përpilimi i një modeli të biznesit për zhvillim të mëtejshëm të infrastrukturës për riciklim të qelqit. Me një rëndësi të madhe është promovimi i rëndësisë së selektimit primar dhe riciklimit, në drejtim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për dobinë e këtyre proceseve që kontribuojnë për mbrojtjen e ambientit jetësor, përmirësimin e shëndetit të njerëzve dhe sigurimin e një dobie ekonomike për të gjithë.

## Është formuar grup punues për implementimin e aktiviteteve të projektit

Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale – BNJVL, më 8 qershor 2020, përmes një video platforme për konferenca mbajti takimin e parë hyrës të grupit punues për implementimin e aktiviteteve të projektit "Menaxhimi i ambalazhit të qelqit në Ballkanin Perëndimor". Qëllimi i grupit punues është vendosja e një dialogu nga anët e përfshira për ndërtim të qasjes dhe politikave për shkak të krijimit të një modeli të suksesshëm, cilësor, efikas dhe të zbatueshëm të grumbullimit dhe riciklimit të ambalazhit të qelqit nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale. Profili i anëtarëve të grupit punues (përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, ministrive, sektorit qeveritar dhe odave ekonomike) është në drejtim të vendosjes së modeleve optimale për grumbullim, transport dhe riciklim të paketimeve të qelqit, të cilat do të ishin të dobishme në mënyrë lokale (publike), ekologjike dhe ekonomike për zbatim. Grupi punues numëron 15 anëtarë.



## Стаклото - материјал што овозможува бесконечен број на циклуси за рециклирање

Отпад од пакување вклучува: пластика, хартија и картон, метал, дрво и стакло. Отпадот од стакло учествува со околу 4% од целиот отпад од пакување во регионот. Стаклото е еден од вкупно двата 100% материјали за рециклирање, со можен бесконечен број на циклуси за рециклирање. Користењето рециклирано стакло има дополнителни еколошки ефекти: рециклирањето на стакло заштедува околу 40% од енергијата и 50% од водата потребна за производство на ново стакло за пакување, а во таа постапка за 20 % се намалува и загадувањето на воздухот.

Процентот на користено стакло за пакување, добиено по пат на рециклирање во регионот на Западен Балкан е далеку под просекот во Европската Унија. Всушност, повеќето од користената стаклена амбалажа завршува на депонии или нелегални места за фрлање отпад, каде што на стаклото му се потребни повеќе од 5000 години да се распадне. Споредено со другиот отпад од пакување, стаклото е потешко и многу поскапо за транспорт. Трошокот за превоз е еден од главните фактори за намалување на вредноста на стаклото како рециклирачки извор. Во земјите на Западен Балкан, во моментов не постои функционален систем за управување со рециклирање на стакло и нема адекватни податоци за рециклирање на стакло што би претставувале појдовна точка да се овозможи економски ефикасен синџир на вредности за рециклирање на стакло и подобрување на соработка на многу различни засегнати страни во текот на целиот процес. Исто така во регионот, засега, нема соодветни структури и капацитети за целосен третман за повторна употреба на стакло за отпад, освен нешто во Србија, каде се нуди пред-преработка на стаклен отпад за понатамошно рециклирање и производство. Ова се дел од причините поради кои започна реализацијата на овој регионален проект – „Управување со отпад од пакување од стакло во Западен Балкан".

## Qelqi është materiali që mundëson numrin e pafundit të cikleve të riciklimit

Mbeturinat e paketimit përfshijnë: plastikën, letrën dhe kartonin, metalin, drurin dhe qelqin. Mbeturinat e qelqit marrin pjesë me rreth 4% të të gjitha mbeturinave të paketimit në rajon. Qelqi është një nga gjithsej dy materialeve të riciklueshme 100%, me një numër të pafundit të cikleve të riciklimit. Përdorimi i qelqit të ricikluar ka efekte ekologjike shtesë: riciklimi i qelqit kursen rreth 40% të energjisë dhe 50% të ujit të nevojshëm për t'u prodhuar qelq i ri për paketim, ndërsa në atë procedurë reduktohet për 20% edhe ndotja e ajrit.

Përqindja e qelqit të përdorur për paketim, të fituar me anë të riciklimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor është larg mesatares në Bashkimin Evropian. Në fakt, shumica e ambalazhit të përdorur të qelqit përfundon në deponitë ose vendet jo legale për hedhje të mbeturinave, ku qelqi kërkon më shumë se 5.000 vjet për t'u shkatërruar. Në krahasim me mbeturinat e tjera të paketimit, qelqi është më i rëndë dhe shumë më i shtrenjtë për transport. Kostot për transport është një nga faktorët kryesorë për ulje të vlerës së qelqit si burim riciklimi. Në Ballkanin Perëndimor, aktualisht nuk ka një sistem funksional për menaxhim me riciklimin e qelqit dhe nuk ka të dhëna adekuate për riciklimin e qelqit që do të ishin një pikënisje për t'u mundësuar një zinxhir ekonomikisht efikas i vlerave për riciklim të qelqit dhe përmirësim të bashkëpunimit të shumë palëve të ndryshme të përfshira gjatë gjithë procesit. Gjithashtu në rajon, tani për tani, nuk ka struktura dhe kapacitete përkatëse për trajtim të tërësishëm për përdorim të serishëm të qelqit për mbeturina, përveç diçka në Serbi, ku ofrohet një para-përpunim i mbeturinave të qelqit për riciklim të mëtejshëm dhe riciklim. Këto janë një pjesë e shkaqeve për shkak të cilave filloi realizimi i këtij projekti rajonal "Menaxhimi i mbeturinave të paketimit të qelqit në Ballkanin Perëndimor".

# ЗЕЛС, ДРЖАВНИОТ СОВЕТ ЗА ПРЕВЕНЦИЈА НА ДЕТСКО ПРЕСТАПНИШТВО И СОЈУЗОТ НА РОТАРИ КЛУБОВИТЕ ВО ЗЕМЈАВА ПОТПИШАА МЕМОРАНДУМ ЗА СОРАБОТКА

Претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, во име на Заедницата на единиците на локалната самоуправа на Република Северна Македонија, на 8 јуни, 2020 година потпиша Меморандум за соработка со претставниците на: Државниот совет за превенција на детско престапништво и на Сојузот на ротари клубовите во Република Северна Македонија. Со тоа беше потврдена заедничката заложба и интересот за развој и унапредување на системот за правда за децата, со посебен акцент врз превенција на детското престапништво и беше изразена подготвеност за координирана соработка и заеднички придонес на работењето на општинските совети за превенција на детско престапништво и на Државниот совет за превенција.

Во Меморандумот е утврден и делокругот на соработка на овие три институции, а кој освен поддршка на активностите на Државниот совет за превенција, вклучува и поддршка за имплементација на стратешки документи и акциони планови за превенција за детско престапништво; поддршка за развивање на можности за осовременување на процесот на деинституционализација преку опремување на училници и работилници, набавка на нагледни средства и технички помагала во установи за сместување на деца со решение на центарот за социјални работи или судот. Исто така, се предвидува и поддршка за развивање на воспитно образовни проекти на локално ниво; потоа вклучување на локалната власт во процесот на обезбедување на културно забавен живот на децата во локалните заедници, организирање на слободното време за децата без родителска грижа, децата од маргинализираните и посебно ранливите групи како и низа други активности.

## Општински совет за превенција на детско престапништво

Според Законот за правда на децата (член 158 и член 159), советите на општините, општините во градот Скопје и градот Скопје именуваат општински совети и Совет на градот Скопје за превенција на детско престапништво. Во Законот е утврдено дека членови на општинскиот совет се претставници на подрачните единици на Министерството за внатрешни работи, Министерството за труд и социјална политика, центрите за социјална работа, претставници на Советот на родители во основните и средните училишта, Унијата на средношколци, Адвокатската комора на Република Северна Македонија, здруженија и фондации, јавниот обвинител кој работи во областа на детската деликвенција и судијата за деца од судовите од општа надлежност или судија кој ќе го определи

# BNJVL-JA, KËSHILLI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KRIMIT TË FËMIJËVE DHE LIDHJA E KLUBEVE ROTARY NË VEND NËNSHKRUAN NJË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov, në emër të Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 08 qershor 2020 nënshkroi një Memorandum bashkëpunimi me përfaqësuesit e Këshillit shtetëror për parandalimin e krimit të fëmijëve dhe të Lidhjes së klubeve Rotary në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me këtë u konfirmua zotimi dhe interesi i përbashkët për zhvillimin dhe avancimin e sistemit të drejtësisë për fëmijët me theks të veçantë ndaj parandalimit të krimit të fëmijëve dhe u shpreh një gatishmëri për bashkëpunim të koordinuar dhe kontribut të përbashkët për punën e këshillave komunalë për parandalimin e krimit të fëmijëve dhe të Këshillit shtetëror të parandalimit.

Në Memorandum është përcaktuar edhe fusha e bashkëpunimit të këtyre tri institucioneve, i cili përveç mbështetjes së aktiviteteve të Këshillit shtetëror të parandalimit, përfshin edhe mbështetjen për implementimin e dokumenteve strategjike dhe planeve aksionare të parandalimit të krimit të fëmijëve; mbështetjen për zhvillimin e mundësive për modernizimin e procesit të deinstitucionalizimit me pajisjen e klasave dhe punëtorive, prokurimin e mjeteve vizuale dhe ndihmesave teknike në institucione për akomodimin e fëmijëve me vendim të Qendrës për çështje sociale ose gjykatës. Gjithashtu parashihet edhe mbështetja për zhvillimin e projekteve edukative arsimore në nivel lokal, pastaj përfshirja e pushtetit lokal në procesin e sigurimit të jetës kulturore argëtuese të fëmijëve në bashkësitë lokale, organizimi i kohës së lirë për fëmijët pa përkujdesje prindërore, fëmijët e grupeve të margjinalizuara dhe grupeve veçanërisht të pambrojtura, si dhe një sërë aktivitetesh të tjera.

## Këshilli komunal për parandalimin e krimit të fëmijëve

Sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve (neni 158 dhe neni 159), këshillat e komunave, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit emërojnë këshilla komunalë dhe një Këshill të Qytetit të Shkupit për parandalimin e krimit të fëmijëve. Në Ligj është përcaktuar se anëtarë të këshillit komunal janë përfaqësues të njësive rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Qendrave të punës sociale, përfaqësues të këshillit të prindërve në shkollat fillore dhe të mesme, Unionit të nxënësve të shkollave të mesme, Odës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shoqatave dhe fondacioneve, prokurori publik i cili punon në sferën e delikuencës së fëmijëve dhe gjyqtari për fëmijët e gjykatave të juridiksionit të







претседателот на судот. Бројот на членовите во ова советодавно тело се утврдува во зависност од големината, развиеноста и потребите на општината или градот, како и во зависност од обемот на детското престапништво во единицата на локална самоуправа. Општинските совети донесуваат годишни програми за својата работа што ја усвојуваат советите на општините и Советот на градот Скопје, деловник за својата работа, вршат работи за следење на состојбите, покренуваат иницијативи за нивното подобрување и развиваат програми за вклучување на локалната заедница во превенција на детското престапништво и третманот на деца сторители на дејствија што со закон се предвидени како кривични дела и прекршоци. За својата работа општинските совети најмалку еднаш годишно го известуваат Советот на општината, односно градот Скопје, како и Државниот совет за превенција на детско престапништво. Програмата на општинските совети од ставот (1) на овој член се финансира врз основа на финансиски план од буџетот на општината, односно градот Скопје и од други средства.

përgjithshëm ose gjyqtari të cilin do ta emërojë kryetari i gjykatës. Numri i anëtarëve në këtë trup këshillëdhënës përcaktohet varësisht nga madhësia, zhvillimi dhe nevojat e komunës ose Qytetit, si dhe varësisht nga vëllimi i krimit të fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Këshillat komunalë përgatisin programe vjetore për punën e tyre që i miratojnë këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, rregullore për punën e tyre, kryejnë punë për ndjekjen e gjendjeve, nisin iniciativa për përmirësimin e tyre dhe zhvillojnë programe për përfshirje të njësisë lokale në parandalimin e krimit të fëmijëve dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave të cilat, sipas ligjit, janë vepra penale dhe kundërvajtje. Për punën e tyre, këshillat komunalë njoftojnë të paktën njëherë në vit këshillin e komunës, gjegjësisht Qytetin e Shkupit, si dhe Këshillin shtetëror për parandalimin e krimit të fëmijëve. Programi i këshillave komunalë nga paragrafi (1) i këtij neni financohet në bazë të planit financiar të buxhetit të komunës, përkatësisht Qytetit të Shkupit, por edhe me mjete të tjera.

## ПОТРЕБА ЗА ПОСТОЈАНА ЕДУКАЦИЈА НА СОВЕТНИЦИТЕ ОД ОБЛАСТА НА УРБАНИСТИЧКОТО ПЛАНИРАЊЕ

## NEVOJË PËR EDUKIM TË VAZHDUESHËM TË KËSHILLTARËVE NGA SFERA E PLANIFIKIMIT URBANISTIK

Предизвиците со кои се соочува локалната власт околу имплементирањето на новиот Закон за урбанистичко планирање беше главната дискусија на општинските советници од тематската работна група за урбанизам и просторно планирање на средбата што се одржа на 12 јуни, 2020 година, преку ZOOM платформата. На оваа онлајн средба се приклучија и претседателите на советите, како и претседателите на комисиите за урбанизам и просторно планирање од 24 партнерски општини на проектот „Зајакнување на општинските совети".

Поканетата архитектка, Даница Павловска, во своето излагање акцентот го стави на новите законски решенија од Закон за урбанистичко планирање, активностите што треба да ги спроведат единиците на локална самоуправа, предизвиците од имплементацијата на Законот, при што сето тоа беше разгледувано од аспект на улогата на Советот на општината, односно на

Sfidat me të cilat ballafaqohet pushteti lokal në implementimin e Ligjit të ri për planifikim urbanistik ishin diskutimi kryesor i këshilltarëve komunalë të grupit punues tematik për urbanizëm dhe planifikim hapësinor në takimin që u mbajt më 12 qershor 2020, përmes platformës ZOOM. Në këtë online takim u bashkëngjitën edhe kryetarët e këshillave si dhe kryetarët e komisioneve të urbanizmit dhe planifikimit hapësinor të 24 komunave partnere të projektit "Përforcimi i këshillave komunalë".

Arkitektja e ftuar, Danica Pavllovska në fjalimin e saj ua vuri theksin zgjidhjeve të reja ligjore të Ligjit për planifikim urbanistik, aktivitetet që duhet t'i zbatojnë njësitë e vetëqeverisjes lokale, sfidat e implementimit të Ligjit, me ç'rast të gjitha këto gjëra u shqyrtuan nga aspekti i rolit të Këshillit të komunës, përkatësisht të këshilltarëve në të gjithë atë proces. Ajo theksoi se planifikimi



советниците во целиот тој процес. Таа посочи дека урбанистичкото планирање на општината претставува голема одговорност на советниците. На средбата стана збор и за начинот на функционирање на советот по овие прашања во услови на пандемијата со Ковид-19, но и генерално, како локалната власт може да придонесе со квалитетни урбанистички решенија за обезбедување на поголема урбана безбедност во услови на пандемија, елементарни непогоди и слично. Законот за урбанистичко планирање овозможува олеснување на некои постапки за кои е потребна согласност од градоначалникот, но многу е значајна и улогата на советниците за што е потребно нивно подобро едуцирање во оваа област, во насока на донесување на адекватни одлуки, како и консултации и вклучување на професионалци од областа на урбанизмот, со цел донесување на квалитетни планови за уредување на просторот во општината. Особено беше нагласено дека сè повеќе се наметнуваат „новите урбанистички потреби" на населението, кои се темелат на зголемување на зелените површини во градовите, изградба на паркови, зголемување на бројот на „зоните без возила" во градските јадра, развивање на велосипедска инфраструктура и слично.

urbanistik i komunës është një përgjegjësi e madhe e këshilltarëve. Në takim u bë fjalë edhe për mënyrën e funksionimit të këshillit në lidhje me këto çështje në kushte të pandemisë me virusin COVID-19, por edhe në përgjithësi dhe se si pushteti lokal mund të kontribuojë me zgjidhje cilësore urbanistike për të siguruar një siguri më të madhe urbanistike në kushte të pandemisë, fatkeqësi elementare dhe e ngjashme. Ligji për planifikim urbanistik mundëson lehtësimin e disa procedurave për të cilat ka nevojë për pajtueshmëri nga kryetari i komunës, por është shumë i rëndësishëm edhe roli i këshilltarëve dhe për këtë arsye ka nevojë për edukim të tyre më të mirë në këtë sferë, në drejtim të miratimit të vendimeve adekuate, si dhe konsultime dhe përfshirje e profesionistëve të sferës së urbanizmit me qëllim që të përgatiten plane cilësore për rregullimin e hapësirës në komunë. Veçanërisht u theksua se gjithnjë e më shumë imponohen "nevojat e reja urbanistike" të popullatës, të cilat bazohen në rritjen e hapësirave të gjelbra në qytete, ndërtimin e parqeve, rritjen e numrit të "zonave pa automjete" në vendet qendrore të qyteteve, zhvillimin e infrastrukturës së biçikletave dhe të ngjashme.

## ВТОРА ГОДИНА ПО РЕД ОПШТИНИТЕ БЕЛЕЖАТ ПОРАСТ НА АКТИВНАТА ТРАНСПАРЕНТНОСТ

Според „Индексот на активна транспарентност за 2020 година", четиринаесет општини заземаат високи позиции на табелата за објавување на информации на сопствена иницијатива, без притоа некој да има доставено до нив барање за пристап до тие информации. Ова го покажа истражувањето што беше спроведено во периодот од 12 март до 6 април, 2020 година од страна на Центарот за граѓански комуникации, со поддршка на УСАИД. Во истражувањето, што се спроведува петта година по ред, вклучени се 98 институции кои се директни носители на извршната власт на централно и на локално ниво (општини, Влада на РСМ, министерства), а се спроведува врз основа на претходно изработена методологија и структурирани прашалници за состојбата на исполнетост на обврските за активно објавување на информациите на интернет-страниците на институциите.

Втора година по ред, активната транспарентност на општините бележи пораст и за 2020 година изнесува 54,5% (од максимално можни 100%). Активната транспарентност на министерствата сè уште е значително подобра од онаа на општините и годинава изнесува 77,1%. Активната транспарентност на сите институции за 2020 година изнесува 58,2 % и според градацијата на нивоата, спаѓа во 'просечна'активна транспарентност.

### Четиринаесет општини на врвот на листата

Од единиците на локалната власт, годинава Општина Велес има најголема транспарентност, односно 94,4 % исполнетост на обврските за објавување на јавни информации. Пред неа е Министерството за одбрана со 97,9 %. Меѓу 21 институција на врвот на листата, оваа година има дури 14 општини, за разлика од лани, кога во оваа група имаше осум општини. Тука се општините: Карпош со 91,4%, која се наоѓа на третото место (по МО и Општина Велес), по неа е Општина Крива Паланка, со 89,9%, па Битола и Демир Хисар со 88,4%; Македонска Каменица има 85,9% исполнетост на обврските, а Валандово има 85,5%. Висок процент на исполнетост имаат и

## PËR VITIN E DYTË ME RADHË, KOMUNAT SHËNOJNË RRITJE TË TRANSPARENCËS AKTIVE

Sipas "Indeksit të transparencës aktive të vitit 2020", katërmbëdhjetë komuna zënë pozicione të larta në tabelën e publikimit të informacioneve me iniciativë të vetë, pa dërguar dikush deri tek ato një kërkesë për qasje deri te ato informacione. Këtë e tregon hulumtimi që u zbatua në periudhën prej 12 marsit deri më 6 prill 2020 nga ana e Qendrës për komunikime qytetare, me mbështetje të USAID-it. Në hulumtimin që zbatohet për vitin e pestë me radhë, janë përfshirë 98 institucione që janë bartës të drejtpërdrejtë të pushtetit ekzekutiv në nivel qendror dhe lokal (komuna, Qeveria e RMV-së, ministri) dhe zbatohet në bazë të metodologjisë dhe pyetësorëve të strukturuar dhe të përgatitur paraprakisht për gjendjen e përmbushjes së obligimeve për publikim aktiv të informacioneve në faqet e internetit të institucioneve.

Për vitin e dytë me radhë, transparenca aktive e komunave shënon një rritje që për vitin 2020 është 54.5% (nga maksimumi i mundshëm prej 100%). Transparenca aktive e ministrive ende është më e mirë në mënyrë të konsiderueshme se ajo e komunave dhe këtë vit është 77.1%. transparenca aktive e të gjitha institucioneve për vitin 2020 është 58.2% dhe sipas gradacionit të niveleve, gjendet në transparencën "mesatare" aktive.

### Katër komuna në krye të listës

Nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, këtë vit Komuna e Velesit ka transparencë më të madhe, gjegjësisht përmbushje prej 94.4% e obligimeve për publikim të informacioneve publike. Para saj është Ministria e Mbrojtjes me 97.9%. Ndër 21 institucione në krye të listës, këtë vit janë madje 14 komuna për dallim nga viti i kaluar, kur në këtë grup ishin tetë komuna. Këtu janë Komuna e Karposhit me 91.4% e cila gjendet në vendin e tretë (pas Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komunës së Velesit), pas saj është Komuna e Kriva Pallankës me 89.9%, pastaj Komuna e Manastirit dhe ajo e Demir Hisarit me 88.4%, Komuna e Makedonska Kamenicës ka përmbushje prej 85.9% e obligimeve, ndërsa

општините: Зрновци; Гази Баба; Струмица; Делчево; Куманово; Кавадарци и Општина Охрид која има 80,3% исполнетост на обврските. Според Извештајот, само 43, од вкупно 81 општина, оваа година ја подобриле својата активна транспарентност. Минатата година, својата активна транспарентност ја подобриле повеќе општини, односно 70 општини. Лидери во подобрувањето се шест општини кои процентот на исполнетост на обврските, само за една година, го подобриле за повеќе од 20 процентни поени: Валандово, Карпош, Делчево, Центар, Лозово и Росоман. Наспроти тоа, последните 37 места на ранг-листата, сепак им „припаѓаат" на општини кои последните седум општини се рангирани со низок процент на исполнетост на обврските, кој се движи од 17,4% до ниски 4,3%.

Komuna e Vallandovës ka 85.5%. Një përqindje e lartë e përmbushje kanë edhe komunat e Zrnocit, Gazi Babës, Strumicës, Dellçevës, Kumanovës, Kavadarit dhe ajo e Ohrit e cila ka përmbushje prej 80.3% e obligimeve. Sipas raportit, vetëm 43 nga gjithsej 81 komuna këtë vit kanë përmirësuar transparencën e tyre aktive. Vitin e kaluar, transparencën e tyre aktive e kanë përmirësuar më shumë komuna, gjegjësisht 70 komuna. Liderë në përmirësim janë gjashtë komuna të cilat përqindjen e përmbushjes së obligimeve, vetëm për një vit e kanë përmirësuar për më shumë se 20 pika përqindjeje: Vallandova, Karposhi, Dellçeva, Qendra, Llozova dhe Rosomani. Përkundër asaj, 37 vendet e fundit në listën e rangimit megjithatë u takojnë komunave prej të cilave tetë komunat e fundit janë ranguar me një përqindje të ulët të përmbushjes së obligimeve, e cila lëvizet prej 17.4% deri te -4.3%.

### Најмалку информации се објавуваат од областа на буџетската и финансиската транспарентност

Во Извештајот беше забележано дека во однос на одделните области на активната транспарентност – институциите објавуваат најмногу информации од областа на пристапот до информации, а најмалку од областа на буџетската и финансиската транспарентност. Во делот на пристапот до информации, процентот на исполнетост на обврските за активно објавување на овие информации, кои произлегуваат главно од Законот за слободен пристап до информациите од јавен карактер, кај општините изнесува 67%, исто како и лани. Кај областа информации за надлежноста и за услугите, општините имаат просечна исполнетост на обврските за објавување информации од 36% (лани 47%). И општините и министерствата најслабо стојат кај активното објавување информации од областа на буџетската и фискалната транспарентност, каде што од можни 100%, општините исполнуваат само 36% (лани 26 %), а министерствата 42 % (лани 57 %) од обврските за активно објавување информации.

### Më pak informacione publikohen nga sfera e transparencës buxhetore dhe financiare

Në raport është vërejtur se në lidhje me sferat e veçanta të transparencës aktive, institucionet publikojnë më shumë informacione të sferës së qasjes deri te informacionet, ndërsa më pak nga sfera e transparencës buxhetore dhe financiare. Në pjesën e qasjes deri te informacionet, përqindja e përmbushjes së obligimeve për publikim aktiv të këtyre informacioneve, të cilat dalin kryesisht nga Ligji për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik, te komunat është e njëjtë si vitin e kaluar, përkatësisht 67%. Në sferën informacione për kompetencën dhe shërbimet, komunat kanë një përmbushje mesatare të obligimeve për publikim të informacioneve prej 36% (vitin e kaluar 47%). Edhe komunat edhe ministritë kanë rezultate më të dobëta në pjesën e publikimit aktiv të informacioneve të sferës së transparencës buxhetore dhe fiskale, ku nga të mundshmet 100%, komunat përmbushin vetëm 36% (vitin e kaluar 26%), ndërsa ministritë 42% (vitin e kaluar 57%) të obligimeve për publikim aktiv të informacioneve.

### Што е активна транспарентност?

Под „активна транспарентност" се подразбира објавувањето информации на сопствена иницијатива на институциите, без притоа некој да има доставено до нив барање за пристап до тие информации. Сепак, постои и законска основа за активната транспарентност на институциите, која се наоѓа, пред сè, во Законот за слободен пристап до информациите од јавен карактер, но и во низа други закони, како што се Законот за локалната самоуправа, Законот за буџетите, Законот за јавен долг, Законот за финансирање на единиците на локална самоуправа и др. Освен од регулативата, активната транспарентност произлегува и од добрата практика, а институциите имаат обврски за проактивно објавување информации и од акциските планови во рамките на иницијативата за Отворено владино партнерство.

### Çfarë është transparenca aktive?

Nën "transparencën aktive" nënkuptohet publikimi i informacioneve me iniciativën e vetë të institucioneve, pa dërguar dikush deri te ato një kërkesë për qasje deri te ato informacione. Megjithatë, ka edhe një bazë ligjore për transparencë aktive të institucioneve, e cila gjendet, para të gjithash, në Ligjin për qasje të lirë dero te informacionet e karakterit publik, por në një sërë ligjesh të tjera, siç janë Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për buxhetet, Ligji për borxhin publik, Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale etj. Përveç nga rregullativa, transparenca aktive del edhe nga praktika e mirë, ndërsa institucionet kanë obligime për publikim proaktiv të informacioneve edhe nga planet aksionare në kuadër të iniciativës për Partneritetin e hapur qeveritar.

**Вкупно рангирање според Индексот на активна транспарентност 2020**

| Ранг | Институција | Резултат | Ранг | Институција | Резултат |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Министерство за одбрана | 97,9 % | 11 | Зрновци | 84,5 % |
| 2 | Велес | 94,4 % | 12 | Гази Баба | 84,1 % |
| 3 | Карпош | 91,4 % | 12 | Струмица | 84,1 % |
| 4 | Крива Паланка | 89,9 % | 14 | МИОА | 83,3 % |
| 5 | Битола | 88,4 % | 14 | Влада на РСМ | 83,3 % |
| 5 | Демир Хисар | 88,4 % | 16 | Делчево | 82,6 % |
| 7 | Македонска Каменица | 85,9 % | 16 | Куманово | 82,6 % |
| 8 | Валандово | 85,5 % | 18 | МЗШВ | 81,3 % |
| 9 | МВР | 85,4 % | 18 | Министерство за здравство | 81,3 % |
| 10 | Министерство за финансии | 85,2 % | 20 | Кавадарци | 80,3 % |
| | | | 20 | Охрид | 80,3 % |

# ФИНАЛИЗИРАЊЕ НА ПРОТОКОЛИТЕ ЗА КОМУНИКАЦИЈА И ЗА ИЗРАБОТКА НА ДОКУМЕНТИ ВО ОБЛАСТА НА РОДОВАТА ЕДНАКВОСТ НА ЛОКАЛНО НИВО

Работната група за родова еднаквост при ЗЕЛС одржа онлајн работилница на 17 јуни, 2020 година. Работилницата претставува дел од активностите предвидени во рамките на проектот „Кон родово одговорни општини: зајакнување на општинските капацитети за политики за родова еднаквост и родово одговорно буџетирање" (2019-2021), што ЗЕЛС го спроведува со поддршка на UN Women, телото на ОН за родова еднаквост и зајакнување на општините. Членови на Работната група се општински координатори/-ки за еднакви можности помеѓу жените и мажите кои постигнале позначајни резултати и кои имаат поголемо искуство во работењето во оваа област во својата општина. Целта на оваа онлајн средба беше да се извлечат релевантни насоки за изработка на квалитетни протоколи за интерна комуникација при подготовката на документи во областа на родовата еднаквост на локално ниво, како и протоколи за комуникации со јавноста, за прашања од оваа област.

Во рамките на проектот веќе се дефинирани протоколи за изработка на стратешки документи и акциски планови за еднаквите можности во општините и истите беа презентирани на работилницата. Станува збор за протоколи за подготовка на програма; буџет; Стратегија за родова еднаквост во општината, во кои е утврдена целата постапка на „движење" на информациите, дефинирани се каналите за комуникација; утврдени се субјектите одговорни за обезбедување на потребните податоци; начинот на изработката на родовата анализа, како и процесот на доставување на документот до Комисијата за еднакви можности и до Советот на општината. Конкретно беше претставен протоколот: „Допис до секторите"- кога координаторот за еднакви можности комуницира со своите колеги од различни сектори, како и протоколот: „Допис до Советот на општината". Беше презентиран и „Протоколот за организација на собир на граѓани/Форум", со цел обезбедување на партиципативно учество на граѓаните во процесот на изработка на активности и програми за подобрување на родовата еднаквост во општината во согласност со нивните потреби.

## Предложено верификување на протоколите од страна на Лоби групата за родова еднаквост при ЗЕЛС

Учесниците на работилницата ги оценија протоколите како практични и изразија надеж дека тие ќе им обезбедат значајна поддршка при спроведувањето на обврските, со оглед на одговорноста што ја имаат: да даваат предлози и мислења поврзани со еднаквите можности до Советот; да изработуваат извештаи за состојбата со еднаквите можности и недискриминацијата; да ја организираат работата на Комисијата за еднакви можности; да соработуваат со невладините организации и со останатите институции на локално ниво; да ја следат состојбата во оваа област и да предлагаат иницијативи и мерки за нејзино подобрување. Во таа насока, поголемиот број од присутните укажаа на предизвиците со кои се соочуваат во комуникацијата со општинската администрација и со избраните функционери во општината при извршувањето на овие обврски и при собирањето на релевантните податоци. Присутните посочија дека унифицираноста на протоколите за комуникација во сите општини и нивна претходна верификација од страна на Лоби групата за родова еднаквост при ЗЕЛС, ќе претставува важен сегмент во

# FINALIZIMI I PROTOKOLLEVE TË KOMUNIKIMIT DHE PËRPILIMIT TË DOKUMENTEVE NË SFERËN E BARAZISË GJINORE NË NIVEL LOKAL

Grupi punues për barazi gjinore pranë BNJVL-së mbajti online punëtori më 17 qershor 2020. Punëtoria është pjesë e aktiviteteve të parapara në kuadër të projektit "Drejt komunave të përgjegjshme gjinore: përforcimi i kapaciteteve komunale për politika për barazi gjinore dhe buxhetim të përgjegjshëm gjinor (2019-2021)" që e zbaton BNJVL-ja me mbështetje të UN Women, trupi i OKB-së për barazi gjinore dhe përforcim të komunave. Anëtarë të grupit punues janë koordinatorët/koordinatoret komunale për mundësi të barabarta midis femrave dhe meshkujve të cilët kanë arritur rezultate më të rëndësishme dhe të cilët kanë një përvojë më të madhe në punën në këtë sferë në komunën e tyre. Qëllimi i këtij online takimi ishte që të merren drejtime relevante për përgatitje të protokolleve relevante për komunikim të brendshëm gjatë përgatitjes së dokumenteve në sferën e barazisë gjinore në nivel lokal, si dhe protokolleve të komunikimit me opinionin për çështje të kësaj sfere.

Në kuadër të projektit tashmë janë përcaktuar protokolle për përpilim të dokumenteve strategjike dhe planeve aksionare për mundësi të barabarta në komuna dhe të njëjtat u prezantuan në punëtorinë. Bëhet fjalë për protokolle për përpilim të programit, të buxhetit, të strategjisë së barazisë gjinore në komunë, në të cilat është përcaktuar procedura e tërësishme e "lëvizjes" së informacioneve; janë përcaktuar kanalet e komunikimit; janë përcaktuar subjektet përgjegjëse për sigurimin e të dhënave të nevojshme; mënyra e përpilimit të analizës gjinore si dhe procesi i dërgimit të dokumentit deri te Komisioni për mundësi të barabarta dhe deri te Këshilli i komunës. Konkretisht u prezantua protokolli "Shkresë për sektorët" – kur koordinatori për mundësi të barabarta komunikon me kolegët e tij të sektorëve të ndryshëm, si dhe protokolli "Shkresë për Këshillin e komunës". U prezantua edhe "Protokolli për organizimin e tubimit të qytetarëve/Forum" me qëllim që të sigurohet pjesëmarrje participative e qytetarëve në procesin e përpilimit të aktiviteteve dhe programeve për përmirësim të barazisë gjinore në komunë në përputhje me nevojat e tyre.

## Është propozuar verifikim i protokolleve nga ana e grupit të lobimit për barazi gjinore pranë BNJVL-së

Pjesëmarrësit në punëtori vlerësuan se protokollet janë praktike dhe shprehën shpresë se ato do t'u sigurojnë një mbështetje të rëndësishme gjatë realizimit të obligimeve, duke marrë parasysh përgjegjësinë që e kanë: të japin propozime dhe mendime të lidhura me mundësitë e barabarta deri te këshilli; të përgatisin raporte për gjendjen e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit; të organizojnë punën e Komisionit të mundësive të barabarta; të bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare dhe me institucionet e tjera në nivel lokal; të ndjekin gjendjen në këtë sferë dhe të propozojnë iniciativa dhe masa për përmirësim të saj. Në këtë drejtim, numri më i madh i të pranishmëve theksuan sfidat me të cilat ballafaqohen në komunikimin me administratën komunale dhe me funksionarët e zgjedhur në komunë gjatë kryerjes së këtyre obligimeve dhe gjatë grumbullimit të të dhënave relevante. Të pranishmit theksuan se unifikimi i protokolleve të komunikimit në të gjitha komunat dhe verifikimi i tyre i mëparshëm nga ana e grupit të lobimit për barazi gjinore të BNJVL-së do ë jetë një segment i rëndësishëm

обезбедувањето на поголема посветеност на локалната власт во справувањето со предизвиците од родовата еднаквост. Беше истакната и потребата за изработка на протокол за собирање на родово разделени податоци во општината, за што беше договорено ЗЕЛС да организира нова работилница во текот на следниот месец.

Овие практични протоколи за комуникација и за изработка на општински документи за родова еднаквост ќе бидат поставени на е-платформата за родова еднаквост http://rob.zels.org.mk/. Исто така, тие ќе бидат споделени и со асоцијациите на локалните власти во земјите од регионот (преку НАЛАС), сè со цел обезбедување на нивна поширока промоција како добри искуства што може да се користат од другите општини во регионот.

në sigurimin e një përkushtimi më të madh të pushtetit lokal në ballafaqimin me sfidat e barazisë gjinore. U theksua edhe nevoja për përpilim të një protokolli të grumbullimit të të dhënave të ndara gjinore në komunë, për të cilën gjë u ra dakord që BNJVL-ja të organizojë një punëtori të re gjatë muajit të ardhshëm.

Këto protokolle praktike të komunikimit dhe të përpilimit të dokumenteve komunale për barazi gjinore do të vendosen në e-platformën e barazisë gjinore http://rob.zels.org.mk/. Gjithashtu, ato do të ndahen edhe me asociacionet e autoriteteve lokale në vendet e rajonit (përmes NALAS-it), gjithnjë me qëllim që të sigurohet promovimi i tyre më i gjerë si përvoja të mira që mund të përdoren edhe nga ana e komunave të tjera në rajon.

## ГОДИШНИОТ ИЗВЕШТАЈ НА ЗЕЛС ЗА 2019 ГОДИНА ПОДГОТВЕН ВО ЕЛЕКТРОНСКО ИЗДАНИЕ

Годишниот извештај на ЗЕЛС за 2019 година беше подготвен само во електронско издание, а не и во печатена форма, поради состојбите со вирусот COVID -19 во нашата земја. Ова, петнаесетто поредиздание, претставува уште една дополнителна алатка преку која ЗЕЛС на транспарентен начин ги прикажува активностите и резултатите реализирани во текот на годината, како и приходите, расходите и Ревизорскиот извештај за 2019 година.

Во него е прикажано работењето на органите и телата на ЗЕЛС, реализацијата на стратегиските цели преку лобирањето, како и работењето на зајакнување на капацитетите на општинската администрација преку ЗЕЛС тренинг центарот. Од голема важност се и реализираните активности на поддршката што ЗЕЛС им ја дава на општините во делот на електронските услуги. Сите активности се прикажани преку бројки на остварени приходи и расходи и потврдени со ревизорски извештај.

„Годишниот извештај на ЗЕЛС за 2019 година" е подготвен на два јазика: македонски и албански, но обезбеден е превод и на англиски јазик. Извештајот е испратен преку електронска пошта до сите општини и истиот е усвоен од Управниот одбор на ЗЕЛС и ставен на разгледување на Генералното собрание на ЗЕЛС. „Годишниот извештај на ЗЕЛС за 2019 година" е поставен и на нашата веб-страница: www.zels.org.mk.

## RAPORTI VJETOR I BNJVL-SË PËR VITIN 2019 I PËRGATITUR NË PUBLIKIM ELEKTRONIK

Raporti vjetor i BNJVL-së për vitin 2019 u përgatit vetëm në publikim elektronik, e jo edhe në formë të shtypur për shkak të gjendjeve me virusin COVID-19 në vendin tonë. Ky publikim i pesëmbëdhjetë me radhë është edhe një vegël shtesë përmes së cilës BNJVL-ja tregon në mënyrë transparente aktivitetet dhe rezultatet e realizuara gjatë vitit, si dhe të ardhurat, të dalat dhe Raporti i auditimit për vitin 2019.

Në të është prezantuar puna e organeve dhe trupave të BNJVL-së, realizimi i qëllimeve strategjike përmes lobimit, si dhe puna për përforcimin e kapaciteteve të administratës komunale përmes Qendrës së Trajnimeve së BNJVL-së. Shumë të rëndësishme janë edhe aktivitetet e realizuara të përkrahjes që ua jep BNJVL-ja komunave në pjesën e shërbimeve elektronike. Të gjitha aktivitetet janë treguar përmes numrave të të arhurave dhe të dalave të realizuara dhe ato janë konfirmuar me raportin e auditimit.

Raporti vjetor i BNJVL-së për vitin 2019 është përgatitur në dy gjuhë: maqedonase dhe shqipe, por është siguruar përkthim edhe në gjuhën angleze. Raporti është dërguar përmes postës elektronike deri te të gjitha komunat dhe i njëjti është miratuar nga Bordi drejtues i BNJVL-së dhe është vendosur për shqyrtim në Kuvendin gjeneral të BNJVL-së. "Raporti vjetor i BNJVL-së për vitin 2019" është vendosur në faqen tonë të internetit: www.zels.org.mk.






# НА ТРИНАЕСЕТТАТА СЕДНИЦА НА УПРАВНИОТ ОДБОР ДОНЕСЕНИ НИЗА ИНИЦИЈАТИВИ И СТАВОВИ ЗА РАЗРЕШУВАЊЕ НА ПРЕДИЗВИЦИТЕ ВО ЛОКАЛНАТА ВЛАСТ

Управниот одбор на ЗЕЛС на 18 јуни, 2020 година ја одржа тринаесеттата седница на која беа усвоени документи за финансиското работење на ЗЕЛС, но истовремено беа покренати и одредени иницијативи во насока за поквалитетно надминување на актуелните состојби и подобрување на функционалноста на локалната власт. Седницата се водеше по електронски пат, преку користење на софтверска платформа достапна на интернет, во согласност со статутарните измени што Генералното собрание на ЗЕЛС ги усвои минатата година.

На самиот почеток на седницата членовите на Управниот одбор одлучија материјалите за шестата седница на Генералното собрание на ЗЕЛС да се доставаат по електронска пошта, а делегатите по нив да се изјаснат најдоцна во периодот од 25 до 30 јуни, 2020 година, до 12.00 часот.

## Усвоени завршните документи и ревизорскиот извештај за работењето на ЗЕЛС во минатата година

Членовите на Управниот одбор ја разгледа, а потоа и ја усвоија завршната сметка на ЗЕЛС за 2019 година. Градоначалникот на Општина Прилеп, Илија Јованоски, кој воедно е и претседател на Надзорниот одбор на ЗЕЛС, упати пофални зборови за рационалното користење на приходите и за успешното менаџирање околу исплатата на заостанатите долгови на општините кон ЗЕЛС. Исто така, присутните го усвоија и Извештајот на независна ревизорска куќа за финансиското работење на ЗЕЛС за 2019 година.. Управниот Одбор го усвои и Предлог - извештајот за работата на ЗЕЛС за 2019 година, во кој прегледно се изнесени сите активности на телата и органите; процесите на лобирањето до централната власт; континуираното информирање на општините; реализираните обуки за јакнење на капацитетите на општинската администрација; поддршката на општините во користењето на информациските системи; реализацијата на одредени проекти поддржани од донаторски организации; како и соработката што ЗЕЛС активно ја спроведува со многу домашни и странски организации.

# NË SEANCËN E TREMBËDHJETË TË BORDIT DREJTUES U MORËN NJË SËRË INICIATIVASH DHE QËNDRIMESH PËR ZGJIDHJEN E SFIDAVE NË PUSHTETIN LOKAL

Bordi drejtues i BNJVL-së më 18 qershor 2020 mbajti seancën e tij të trembëdhjetë në të cilën u miratuan dokumente për punën financiare të BNJVL-së, por në të njëjtën kohë u iniciuan edhe iniciativa të caktuara në drejtim të tejkalimit më cilësor të gjendjeve aktuale dhe përmirësimit të funksionalitetit të pushtetit lokal. Seanca u zhvillua në mënyrë elektronike, përmes përdorimit të platformës softuerike që është në dispozicion në internet, në përputhje me ndryshimet statutore që i miratoi Kuvendi gjeneral i BNJVL-së vitin e kaluar.

Në vetë fillimin e seancës, anëtarët e Bordit drejtues vendosën që materialet për seancën e gjashtë të Kuvendit gjeneral të BNJVL-së të dërgohen përmes postës elektronike, ndërsa delegatët të prononcohen për të njëjtat më së voni në periudhën prej 25 deri më 30 qershor, deri në orën 12.00.

## Janë miratuar dokumentet përfundimtare dhe raporti i auditimit për punën financiare të BNJVL-së në vitin e kaluar

Anëtarët e Bordit drejtues shqyrtuan dhe pastaj miratuan llogarinë përfundimtare të BNJVL-së për vitin 2019. Kryetari i Komunës së Prilepit, Ilija Jovanoski, i cili është në të njëjtën kohë edhe kryetar i Bordit mbikëqyrës të BNJVL-së, dërgoi fjalë lavdërimi për përdorimin racional të të ardhurave dhe për menaxhimin e suksesshëm rreth pagesës së borxheve të mbetura të komunave ndaj BNJVL-së. Gjithashtu, të pranishmit miratuan edhe Raportin e Shtëpisë së pavarur së auditimit për punën financiare të BNJVL-së për vitin 2019. Bordi drejtues miratoi edhe Propozim – Raportin e punës së BNJVL-së për vitin 2019, në të cilin në mënyrë të qartë janë prezantuar të gjitha aktivitetet e trupave dhe organeve; proceset e lobimit para pushtetit qendror; informimi i vazhdueshëm i komunave; trajnimet e realizuara për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale; përkrahja e komunave në përdorimin e sistemeve të informacioneve; realizimi i projekteve të caktuara të mbështetura nga organizatat e donatorëve; si dhe bashkëpunimi që e zbaton BNJVL-ja në mënyrë aktive me shumë organizata vendase dhe të huaja.



**Реафирмација на иницијативата за продлабочување на процесот на децентрализација**

Членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС по точката „разно" изнесоа низа мислења, ставови и иницијативи. Беше нагласена потребата ЗЕЛС да ја реафирмира иницијативата за продлабочување на процесот на децентрализација. Кризата со вирусот COVID-19, што го зафати светот, но и нашата земја претставува дополнителна потврда дека актуелниот систем на локална власт во нашата земја е дисфункционален. Поточно, дека локалните власти во одредени сегменти имаат половични или непрецизно дефинирани ингеренции чие спроведување зависи од вклучувањето или од одлуките на низа институции од централната власт. Во реалноста тоа предизвикува истовремено и незадоволство кај граѓаните од работењето на општината. Со оглед на фактот што корона кризата се очекува да продолжи и во следниот период, беше предложено ЗЕЛС итно да иницира донесување и на комплетно ново законско решение за ингеренциите и улогата на единиците на локална власт во услови на криза или други вонредни ситуации. Присутните се согласија дека нагласената потреба за темелни реформи, односно утврдување на функционален механизам за справување со елементарни непогоди, епидемии, пандемии и други кризни ситуации, е дополнително потврдена и од евидентната некоординираност на трите државни институции надлежни за справување со кризи во земјава и нивната „тромост" во преземањето на потребните мерки. Беше заклучено Управниот одбор да ги нотира сите предизвици со кои локалните власти се соочиле во услови на криза и да даде предлози за ингеренциите што општините би требало да ги имаат во вакви услови. Притоа, беше нагласено дека треба да се посвети посебно внимание и на улогата на територијалните противпожарни единици, на можностите за префрлање на одредени ингеренции на полицијата на локални ниво, но и на надлежностите на инспекциските служби.

**Владините мерки за отсуство од работа на одредени категории на граѓани, значително влијаат врз ефикасното работење на општините**

Градоначалниците посочија на негативните рефлексии од користењето на владините мерки (отсутност на родители на деца до 10 години, хронично болни и друго....) од страна на општинската администрација, врз работењето на општината. Беше предложено да се испрати допис до Владата во насока на ревидирање на оваа одлука, особено за намалување на возрасната граница на децата чии родители остануваат дома за нивно згрижување. Присутните беа информирани дека иницијатива за разрешување на ова прашање ЗЕЛС веќе има испратено до Владата на РСМ, како резултат на доставена реакција од неколку општини, но досега не стигнал повратен одговор.

**Иницирање за отворање на дијалог со МОН и со МФ за навремена поддршка на општините, доколку во септември продолжи „рационализацијата" на капацитетите на автобусите за превоз на учениците**

Беше изнесена и потребата за иницирање на барање до централната власт за навремено преземање на мерки со кои ќе се поддржат локалните власти во делот на задолжителниот превозот на учениците, доколку во септември корона кризата сѐуште е присутна во земјава и важат мерките на „рационализација" за 50% на капацитетот на автобусите. Во тој случај ќе биде доведена во прашање практичната примена на законските одредби што ги издејствува ЗЕЛС, пред две години, за користење на линискиот

**Riafirmimi i iniciativës për thellimin e procesit të decentralizimit**

Anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së dhanë një sërë mendimesh, qëndrimesh dhe iniciativash lidhur me pikën "të ndryshme". U theksua nevoja që BNJVL-ja ta riafirmojë iniciativën për thellimin e procesit të decentralizimit. Kriza me virusin COVID-19 që e kaploi botën, por edhe vendin tonë, është një konfirmim shtesë se sistemi aktual i pushtetit lokal në vendin tonë është jofunksional. Më saktësisht, se autoritetet lokale në segmente të caktuara kanë kompetenca të përgjysmuara ose të përcaktuara jo saktësisht, zbatimi i të cilave varet nga përfshirja ose nga vendimet e një sërë institucionesh të pushtetit qendror. Në realitet kjo shkakton njëkohësisht edhe një pakënaqësi te qytetarët nga puna e komunës. Duke marrë parasysh se kriza me virusin korona pritet të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, u propozua që BNJVL-ja ta iniciojë urgjentisht miratimin e një zgjidhjeje tërësisht të re ligjore për kompetencat dhe rolin e njësive të pushtetit lokal në kushte të krizës ose situatave të tjera të jashtëzakonshme. Të pranishmit u pajtuan se nevoja e theksuar për reforma themelore, përkatësisht për krijim të një mekanizmi funksional për ballafaqim me fatkeqësitë elementare, epidemitë, pandemitë dhe situatat e tjera të krizave, është konfirmuar në mënyrë shtesë edhe me moskoordinimin e evidentuar të tre institucioneve shtetërore që janë përgjegjëse për ballafaqim me krizat në vend dhe "ngathtësinë" e tyre në ndërmarrjen e masave të nevojshme. U konkludua se Bordi drejtues duhet t'i shënojë të gjitha sfidat me të cilat janë ballafaquar autoritetet lokale në kushte të krizës dhe të japë propozime për kompetencat të cilat do të duhej t'i kishin komunat në kushte të këtilla. Në të njëjtën kohë u theksua se duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë edhe rolit të njësive territoriale të zjarrfikësve, mundësive për transferimin e kompetencave të caktuara të policisë në nivel lokal, por edhe kompetencave të shërbimeve të inspektimit.

**Masat qeveritare për mungesën nga puna të kategorive të caktuara të qytetarëve ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme ndaj punës efikase të komunave**

Kryetarët e komunave theksuan ndikimet negative të përdorimit të masave qeveritare (mungesa e prindërve të fëmijëve deri në moshën dhjetëvjeçare, të sëmurëve kronikë dhe të tjera) nga ana e administratës komunale ndaj punës së komunës. U propozua të dërgohet një shkresë deri te Qeveria në drejtim të revidimit të këtij vendimi, sidomos për zvogëlim të kufirit të moshës së fëmijëve, prindërit e të cilëve qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për ta. Të pranishmit u informuan se BNJVL-ja tashmë ka dërguar një iniciativë deri te Qeveria e RMV-së për t'u zgjedhur kjo çështje, si rezultat i reaksionit të dërguar nga disa komuna, por deri më tani nuk ka ardhur një përgjigje kthyese.

**Iniciativë për hapje të një dialogu me MASH-in dhe me MF-në për mbështetje me kohë të komunave nëse në shtator vazhdon "racionalizimi" i kapaciteteve të autobusëve për transportin e nxënësve**

U shpreh edhe nevoja për inicim të një kërkese deri te pushteti qendror për ndërmarrje me kohë të masave me të cilat do të mbështeten autoritetet lokale në pjesën e transportit të domosdoshëm të nxënësve, nëse në shtator kriza me virusin korona ende është e pranishme në vend dhe vlejnë masat e "racionalizimit" për 50% të kapacitetit të autobusëve. Në atë rast do të vihet në dyshim zbatimi praktik i dispozitave ligjore për të cilat luftoi BNJVL-ja dy vjet më parë për përdorimin e

и меѓуопштинскиот превоз од страна на учениците. Локалните власти би се соочиле со повторно распишување на тендерски постапки, заради потребата од двојно зголемување на бројот на автобуси; повисоки цени за превоз на учениците и слично. Затоа е потребно навремено да се отвори заедничко решавањето на ова прашање со Министерството за образование и наука и со Министерството за финансии, особено во делот на финансиските импликации што оваа мерка би ги предизвикала во општините.

**Недостаток на градежни инспектори - голем предизвик за локалната власт**

Недостатокот на одредени административни кадри во општините, повторно беше тема на разговор и на овој состанок на Управниот одбор на ЗЕЛС. Стана збор за недостатокот на градежни инспектори. Во овој момент, со овој предизвик се соочува Општина Охрид, која реализира поголеми зафати на отстранување на бесправно изградени објекти, па градоначалникот на општината побара поддршка од другите општини од ваков кадар. Беше посочено дека ситуацијата е алармантна во сите општини и дека можеби треба да се размислува во насока на законски измени за промена во условите за вработување на вакви лица, поточно да се овозможи поширока рамка во делот на образованите квалификации на кандидатите, односно да се даде можност да се пријавуваат и правници, урбанисти и слично. Освен овој предизвик во областа на урбанизмот, градоначалниците посочија на уште еден предизвик, поврзан со утврдените „стари градски јадра", заштитени објекти со историско наследство и слично, кои предизвикуваат огромни застои во урбанистичките и градежни решенија на општината. Беше посочено дека Град Скопје веќе има поднесено слична иницијатива до Националниот конзерваториски центар Скопје и дека би било полезно ЗЕЛС да иницира предлог за соодветни законски измени до надлежните институции, во името на сите општини.

**Намалувањето на приливот на средства од ДДВ катастрофално за општините, особено за помалите**

На седницата беше укажано на негативните импликациите што корона кризата ги предизвикува во економијата. Беше посочено дека приливот на средствата од ДДВ во државната каса е значително намален, аналогно со тоа и приливот на приходите на општините по овој основ значително ќе се намали во 2021 година, што е сериозен предизвик за сите локални власти, но особено за помалите општини. Беше нагласено дека за ова прашање треба навремено да се дискутира со централната власт, но истовремено тоа да се разгледа и во еден поширок контекст, во насока на редефинирање на ингеренциите на локалните власти, процес што ЗЕЛС го отвори уште минатата година.

transportit linjor dhe ndërkomunal të nxënësve. Autoritetet lokale do të ballafaqoheshin me shpalljen e serishme të procedurave të tenderit, për shkak të nevojës së rritjes së dyfishtë të numrit të autobusëve; çmimeve më të larta për transportin e nxënësve dhe e ngjashme. Për këtë arsye ka nevojë që të zgjidhet me kohë kjo çështje s bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me Ministrinë e Financave, sidomos në pjesën e implikimeve financiare të cilat do t'i shkaktonte kjo masë në komunat.

**Mungesa e inspektorëve të ndërtimit – sfidë e madhe për pushtetin lokal**

Mungesa e kuadrove të caktuara administrative në komuna, ishte përsëri tema e bisedimit edhe në këtë takim të Bordit drejtues të BNJVL-së. U bë fjalë për mungesën e inspektorëve të ndërtimit. Në këtë moment, me këtë sfidë po ballafaqohet Komuna e Ohrit, e cila realizon aktivitete më të mëdha për t'i larguar objektet e ndërtuara në mënyrë të paligjshme, me ç'rast kryetari i komunës kërkoi mbështetje nga komunat e tjera për kuadro të këtilla. U theksua se situata është alarmante në të gjitha komunat dhe se ndoshta duhet të mendohet në drejtim të ndryshimeve ligjore për t'u ndryshuar kushtet për punësim të personave të këtillë. Më saktësisht të mundësohet një kornizë më e gjerë në pjesën e kualifikimeve arsimore të kandidatëve, gjegjësisht të jepet mundësi të paraqiten edhe juristë, urbanistë dhe e ngjashme. Përveç kësaj sfide në sferën e urbanizmit, kryetarët e komunave theksuan edhe një sfidë tjetër të lidhur me "vendet e vjetra të përcaktuara të qytetit", objektet e mbrojtura me trashëgiminë historike dhe e ngjashme, të cilat shkaktojnë ngecje shumë të mëdha në zgjidhjet urbanistike dhe ndërtimore të komunës. U theksua se Qyteti i Shkupit tashmë ka iniciuar një iniciativë e ngjashme deri te Qendra kombëtare e konservimit Shkup dhe se do të ishte e dobishme që BNJVL-ja të iniciojë deri te institucionet kompetente një propozim për ndryshime përkatëse ligjore, në emër të të gjitha komunave.

**Zvogëlimi i arkëtimit të mjeteve të TVSH-së është katastrofal për komunat, sidomos për ato më të voglat**

Në seancë u theksuan ndikimet negative që shkakton kriza me virusin korona në ekonomi. U theksua se arkëtimi i mjeteve të TVSH-së në arkën e shtetit janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme dhe si pasojë e kësaj, në vitin 2021 do të zvogëlohen në mënyrë të konsiderueshme edhe të ardhurat që i marrin komunat në këtë bazë, që është një sfidë serioze për të gjitha autoritetet lokale, sidomos për komunat më të vogla. U theksua se për këtë çështje duhet të diskutohet me kohë me pushtetin qendror, por të shqyrtohet njëkohësisht edhe në një kontekst më të gjerë në drejtim të ridefinimit të kompetencave të autoriteteve lokale, proces të cilin e hapi BNJVL-ja që në vitin e kaluar.





# УСВОЕНИ ПРЕДЛОГ -УРЕДБИТЕ ЗА РАСПРЕДЕЛБА НА ПРИХОДИ ОД ДДВ И ОД БЛОК ДОТАЦИИТЕ ЗА ЛОКАЛНАТА ВЛАСТ

Комисијата за следење на развојот на финансирање на општините на 19 јуни, 2020 година ја одржа триесетишестата седница по пат на користење на софтверска платформа (ZOOM) достапна на интернет. Членовите на комисијата усвоија поголем број на предлог-уредби кои се однесуваа на методологиите за распределба на приходите од ДДВ, како и приходи од блок дотациите во областа на образованието, социјалната заштита и културата.

Во врска со Предлог – уредбата за методологијата за распределба на приходите од данокот на додадена вредност (ДДВ) по општини за 2021 година беше посочено дека нема промени и дека распределбата ќе се врши како и во изминатите години, по што истата беше усвоена. Средствата од вкупно наплатениот ДДВ во претходната фискална година, во висина од 4,5% одат за општините, на начин што се распределуваат во константен дел од по 3.000.000 денари за сите општини во Република Северна Македонија, за општините во градот Скопје и за Град Скопје и променлив дел кој се распределува за општините во износ од 88%, а за општините во градот Скопје и Град Скопје во износ од 12%. Присутните беа информирани за дискусијата на членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС од последната седница, на која беше искажана загриженост дека се очекува приходите на општините, по овој основ, за следната година да бидат драстично намалени, како рефлексија од целокупната економска состојба предизвикана од кризата со вирусот КОВИД-19. Комисијата донесе заклучок да се обрати до Владата на РСМ и да побара таа навремено да изнајде соодветни решенија поради настанатата состојба, со цел општините да не бидат доведени во уште подлабока финансиска нестабилност. Притоа, беше посочено да се размислува и во правец на преземање на соодветни законски измени.

## Комисијата изнесе препорака за преземање на активности за оптимизација на училишната мрежа

Усвоени беа и предлог-уредбите за методологијата за утврдување на критериуми за распределба на блок дотациите за основното и за средното образование по општините, за 2021 година. Беше посочено дека промени во критериумите за распределбата на овие средства не се направени, односно дека и понатаму еден од основните критериуми е бројот на ученици. Укажано беше на незначителното намалување на средствата со ребалансот на буџетот, при што повторно беше посочено дека општините треба да направат реорганизација на училишната мрежа со оглед на фактот дека бројот на ученици континуирано се намалува, дека има подрачни училишта со по еден или неколку ученици, како и дека бројот на наставници генерално континуирано се зголемува. Во таа насока, Комисијата донесе препорака до сите единици на локална самоуправа што поскоро да започнат со преземање на активности за оптимизација на училишната мрежа, со што ќе се подобрат условите за одвивањето на наставата. Присутните беа информирани дека три средни стручни училишта ќе станат државни, поради што не е прифатен иницираниот критериум за утврдување

# JANË MIRATUAR PROPOZIM-DEKRETET PËR RIALOKIM TË TË ARDHURAVE TË TVSH-SË DHE TË BLLOK-DOTACIONEVE PËR PUSHTETIN LOKAL

Komisioni për ndjekje të zhvillimit të financimit të komunave më 19 qershor 2020 mbajti seancën e tridhjetë e gjashtë me anë të përdorimit të platformës softuerike (ZOOM) që është në dispozicion në internet. Anëtarët e komisionit miratuan numrin më të madh të propozim – dekreteve që kanë të bëjnë me metodologjitë për rialokim të të ardhurave të TVSH-së si dhe të ardhurave të bllok dotacioneve në sferën e arsimit, mbrojtjes sociale dhe kulturës.

Lidhur me Propozim – Dekretin për metodologjinë e rialokimit të të ardhurave të Tatimit të Vlerës së Shtuar (TVSH) nëpër komuna për vitin 2021 u theksua se nuk ka ndryshime dhe se rialokimi do të kryhet sikurse në vitet e kaluara, me ç'rast e njëjta u miratua. Mjetet totale nga TVSH-ja e arkëtuar në vitin e mëparshëm fiskal, në shumë prej 4.5% shkojnë për komunat, në mënyrë në të cilën shpërndahen në një pjesë konstante me nga 3.000.000 denarë për të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për komunat në Qytetin e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit dhe një pjesë e ndryshueshme që shpërndahet për komunat në shumë prej 88%, ndërsa për komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit në shumë prej 12%. Të pranishmit u informuan për diskutimin e anëtarëve të Bordit drejtues të BNJVL-së nga takimi i fundit, në të cilin u shpreh një shqetësim se pritet që të ardhurat e komunave, që fitohen në këtë bazë, të reduktohen në mënyrë drastike vitin e ardhshëm, si refleksion i gjendjes së tërësishme ekonomike të shkaktuar nga kriza me virusin COVID-19. Komisioni mori konkluzion që t'i drejtohet Qeverisë së RMV-së dhe të kërkojë nga ajo të gjejë me kohë zgjidhje adekuate për shkak të gjendjes së krijuar me qëllim që komunat të mos gjenden në një jostabilitet akoma më të thellë financiar. Gjithashtu u theksua se duhet të mendohet edhe në drejtim të ndërmarrjes së ndryshimeve ligjore përkatëse.

## Komisioni dha rekomandim për ndërmarrje të aktiviteteve për optimizmin e rrjetit shkollor

U miratuan edhe propozim – dekretet për metodologjinë e përcaktimit të kritereve për rialokimin e bllok dotacioneve për arsimin fillor dhe të mesëm nëpër komuna për vitin 2021. U theksua se nuk janë bërë ndryshime në kriteret për rialokimin e këtyre mjeteve, përkatësisht se edhe më tej numri i nxënësve është një nga kriteret themelore. U theksua edhe ulja e pakonsiderueshme e mjeteve me rebalancin e buxhetit, kështu që përsëri u potencua se komunat duhet të bëjnë riorganizim i rrjetit shkollor duke marrë parasysh se numri i nxënësve reduktohet në vazhdimësi, se ka shkolla rajonale me nga një ose disa nxënës, si dhe se numri i mësimdhënësve në përgjithësi rritet vazhdimisht. Në atë drejtim, komisioni mori rekomandim për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale që të fillojnë sa më shpejt me ndërmarrjen e aktiviteteve për optimizim të rrjetit shkollor, me ç'rast do të përmirësohen kushtet e zhvillimit të mësimit. Të pranishmit u informuan se tre shkollat e mesme profesionale do të bëhen shtetërore dhe për këtë shkak nuk u pranua kriteri i iniciuar për përcaktimin e një koeficienti të veçantë për arsimin teknik.

на посебен коефициент за техничкото образование. И по оваа точка беше пренесено размислувањето на членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС за можноста од потреба на дополнителни финансиски издатоци за општините за превоз на учениците, доколку кризата со КОВИД -19 продолжи и од септември, односно со почетокот на новата учебна година. Во услови на вонредни мерки, бројот на патници во автобусите се намалува за 50%, па со тоа општината не би можела да го користи линискиот превоз и би требала да обезбеди двојно повеќе автобуси за превоз на учениците, а притоа би била изложена на дополнителни трошоци. Во таа насока, Комисијата го донесе следниов заклучок: Министерството за образование и наука, Министерството за финансии и Владата навремено да утврдат соодветни решенија и да обезбедат дополнителни средства, доколку и во септември важат времените мерки за автобуски превоз на патници.

Членовите на Комисијата ги усвоија и Уредбата за методологијата за утврдување на критериумите за распределба на блок дотациите за јавните установи за деца - детски градинки и центри за ран детски развој во состав на јавни детски градинки по општини за 2021 година, како и Уредбата за методологијата за утврдување на критериуми за распределба на блок дотациите за јавните установи за социјална заштита - домови за стари лица за 2021 година. Бидејќи на седницата немаше претставник од Министерството за труд и социјална политика, (најавена е номинација на ново лице) не беа изнесени ефектите што произлегуваат од измената на критериумите што минатата година беа направени во делот на распределбата на средствата во детските градинки. Беше посочено дека Комисијата очекува на следната седница МТСП да изнесе поопсежни податоци од направените анализи по овој основ.

## Институциите од областа на културата да се префрлат на локално ниво, но само со обезбедени финансиски средства

Во однос на распределбата на средствата од блок дотациите во областа на културата беше посочено дека нема измени од минатата година. Бидејќи не беше поканет претставник од Министерството за култура, присутните немаа можност да се информираат за најновите резултати од активностите на ова Министерство во однос на создавањето на услови за префрлање на најголемиот број културни установи на локално ниво. Сепак, Комисијата донесе заклучок дека локалните власти инсистираат процесот на децентрализација да продолжи, односно институциите од областа на културата да се префрлат на локално ниво, (освен оние за кои ќе биде утврдено дека се од национален интерес), но трансферирањето да биде извршено со соодветни средства, во спротивно нема да биде прифатено. Под точката разно беше посочено дека локалната власт треба навремено да се подготви и да го искористи законското право за реализирање на заеднички средби со централната власт за актуелни прашања поврзани со финансирањето на општините и најдоцна до септември да излезе со препораки до Владата при подготвувањето на буџетот за 2021 година.




Lidhur me këtë pikë gjithashtu u transmetua mendimi i anëtarëve të Bordit drejtues të BNJVL-së për mundësinë e nevojës së shpenzimeve financiare shtesë për komunat për transportin e nxënësve, në rast se kriza me COVID-19 vazhdon edhe nga muaji shtator, përkatësisht me fillimin e vitit të ri shkollor. Në kushte të masave të jashtëzakonshme, numri i udhëtarëve në autobusët reduktohet për 50%, kështu që komuna nuk do të kishte mundësi ta përdorte transportin linjor dhe do të duhej të siguronte dyfish më shumë autobusë për transportin e nxënësve, e në të njëjtën kohë do të ishte ekspozuar ndaj kostove shtesë. Në atë drejtim, komisioni mori këtë konkluzion: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Qeveria të përcaktojnë me kohë zgjidhjet adekuate dhe të sigurojnë mjete shtesë nëse edhe në shtator vlejnë masat e përkohshme për transportin e nxënësve me autobus.

Anëtarët e komisionit miratuan edhe Dekretin për metodologjinë e përcaktimit të kritereve për rialokimin e bllok dotacioneve për institucionet publike të fëmijëve – kopshtet e fëmijëve dhe qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve që janë në përbërjen e kopshteve publike të fëmijëve nëpër komuna për vitin 2021, si dhe Dekretin për metodologjinë e përcaktimit të kritereve për rialokimin e bllok dotacioneve për institucionet publike për mbrojtje sociale – shtëpitë për personat e moshuar për vitin 2021. Sepse nuk kishte përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në takim (është paralajmëruar emërimi i një personi të ri), nuk u prezantuan efektet që dalin nga ndryshimi i kritereve që u bë vitin e kaluar në pjesën e rialokimit të mjeteve në kopshtet e fëmijëve. U theksua se komisioni pritet që MPPS-ja në seancën e ardhshme të japë të dhëna më të gjera nga analizat e bërë në këtë bazë.

## Institucionet e sferës së kulturës të transferohen në nivel lokal, por vetëm me mjete të siguruara financiare

Lidhur me rialokimin e mjeteve të bllok dotacioneve në sferën e kulturës u theksua se nuk ka ndryshime nga viti i kaluar. Sepse nuk u ftua përfaqësues i Ministrisë së Kulturës në takim, të pranishmit nuk kishin mundësi të informohen për rezultatet më të reja të aktiviteteve të kësaj ministrie lidhur me krijimin e kushteve për transferim të numrit më të madh të institucioneve kulturore në nivel lokal. Megjithatë, komisioni mori konkluzion se autoritetet lokale insistojnë të vazhdojë procesi i decentralizimit, përkatësisht institucionet e sferës së kulturës të transferohen në nivel lokal (përveç atyre për të cilat do të konstatohet se janë me interes kombëtar), por transferimi të kryhet me mjete adekuate, në të kundërtën nuk do të pranohet ajo gjë. Nën pikën "të ndryshme" u theksua se pushteti lokal duhet për përgatitet me kohë dhe ta përdorë të drejtën ligjore për realizim të takimeve të përbashkëta me pushtetin qendror për çështje aktuale të lidhura me financimin e komunave dhe të dalë më së voni deri në muajin shtator me rekomandime për Qeverinë gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin 2021.

## ГЕНЕРАЛНОТО СОБРАНИЕ НА ЗЕЛС ЈА ОДРЖА ШЕСТАТА СЕДНИЦА ПО ЕЛЕКТРОНСКИ ПАТ

Генералното собрание на ЗЕЛС ја одржа шестата седница, во согласност со член 16, став 7 од Статутот на ЗЕЛС, каде е утврдено дека ова тело може да работи и на седници кои се одржуваат на електронски начин. Во таа насока, на делегатите по електронска пошта им беа доставени: поканата, дневниот ред и материјалите за седницата, со упатство за начинот на работа, начинот на донесување на одлуките и начинот на гласање. Од вкупно 90 делегати, колку што брои ова највисоко тело на ЗЕЛС, 65 делегати се изјаснија со пополнување на Изјава за начинот на гласање по точките од дневниот ред и истата заверена во форма на електронски документ ја доставија до ЗЕЛС, до 30 јуни, 2020 година, до 12,00 часот, термин утврден како почеток на седницата. На овој начин, Генералното собрание на ЗЕЛС, со мнозинство гласови, ги усвои завршните документи за финансиското работење за претходната година и Извештајот за работата на ЗЕЛС за 2019 година. Шеесет и два градоначалника и тројца делегати од Комитетот на советите се изјаснија позитивно за сите точки, освен еден градоначалник, кој се изјасни воздржан за втората точка- Одлука за усвојување на Извештајот на независна ревизорска куќа за финансиското работење на ЗЕЛС во 2019, а по другите точки даде позитивно мислење. Ставот на делегатите беше дека во услови на зголемен број на заразени од корона вирусот во земјава и потребата за зголемено ниво на одржување на лична заштита, изјаснувањето преку електронска пошта е функционален, а истовремено и легитимен начин на донесување на одлуки на Генералното собрание на ЗЕЛС.

### Дел од активностите посветени на унапредување на системот на локалната самоуправа во земјава

По првата точка од дневниот ред –„Извештај за работата на ЗЕЛС за 2019 година" на делегатите им беше доставено изданието на ‚Годишниот извештај на ЗЕЛС за 2019 година. Во него детално се прикажани активностите и резултатите на органите и телата на ЗЕЛС, реализирани во текот на минатата година, кои се однесуваат на исполнувањето на трите стратегиски цели на ЗЕЛС: 1. Застапување и лобирање; 2. Обезбедување и одржување систем на услуги за единиците на локалната самоуправа (ЕЛС) и 3. Обезбедување одржливост и професионалност на извршната канцеларија. Во 2019 година од особена важност беа активностите поврзани со реализација на иницијативата покрената од страна на Управниот одбор на ЗЕЛС, а потоа прифатена и од Генералното собрание за унапредување на системот на локалната самоуправа во земјава. ЗЕЛС изнесе предлог–концепт за продолжување на процесот на децентрализацијата, утврден во три насоки: фискална децентрализација; проширување на надлежностите на ЕЛС и промени во организацијата на локалната власт. Најголем напредок во разговорите со централната власт беше постигна во делот за проширување на надлежностите. Сепак,

## KUVENDI GJENERAL I BNJVL-SË MBAJTI SEANCËN E GJASHTË NË MËNYRË ELEKTRONIKE

Kuvendi gjeneral i BNJVL-së mbajti seancën e gjashtë në përputhje me nenin 16, paragrafi 7 i Statutit të BNJVL-së, ku është përcaktuar se ky trup mund të punojë edhe në seanca që mbahen në mënyrë elektronike. Në këtë drejtim, delegatëve përmes postës elektronike iu dërguan ftesa, rendi i ditës dhe materialet për seancë, me udhëzim për mënyrën e punës, mënyrën e marrjes së vendimeve dhe mënyrën e votimit. Nga gjithsej 90 delegatë, sa numëron ky trup më i lartë i BNJVL-së, 65 delegatë u prononcuan me plotësimin e Deklaratës për mënyrën e votimit lidhur me pikat e rendit të ditës dhe të njëjtën, të verifikuar në formë të një dokumenti elektronik, e dërguan në BNJVL më 30 qershor 2020, deri në orën 12.00, kohën e caktuar si fillim i seancës. Në këtë mënyrë Kuvendi gjeneral i BNJVL-së me shumicë votash miratoi dokumentet përfundimtare për punën financiare për vitin e mëparshëm dhe Raportin e punës së BNJVL-së për vitin 2019. Gjashtëdhjetë e dy kryetarë komunash dhe tre delegatë të Komitetit të këshillave u prononcuan pozitivisht për të gjitha pikat, përveç një kryetari komune, i cili u prononcua i përmbajtur për pikën e dytë – Vendim për miratim të Raportit të shtëpisë së pavarur së auditimit për punën financiare të BNJVL-së në vitin 2019, ndërsa dha mendim pozitiv lidhur me pikat e tjera. Qëndrimi i delegatëve ishte se në kushte të një numri të rritur të të infektuarve me virusin korona në vend dhe nevoja për nivelin e rritur të mbajtjes së mbrojtjes personale, prononcimi përmes postës elektronike është një mënyrë funksionale dhe në të njëjtën kohë legjitime e vendimmarrjes së Kuvendit gjeneral të BNJVL-së.

### Një pjesë e aktiviteteve të përkushtuara për avancimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në vend

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës – "Raport për punën e BNJVL-së për vitin 2019", delegatëve u dërgua botimi i "Raportit vjetor të BNJVL-së për vitin 2019". Në të janë treguar në mënyrë detale aktivitetet dhe rezultatet e organeve dhe trupave të BNJVL-së, të realizuara gjatë vitit të kaluar, që kanë të bëjnë me plotësimin e tri qëllimeve strategjike të BNJVL-së: 1. Përfaqësimi dhe lobimi; 2. Sigurimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të shërbimeve për njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL-të) dhe 3. Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të zyrës ekzekutive. Në vitin 2019, me një rëndësi të madhe ishin aktivitetet e lidhura me realizimin e iniciativës së nisur nga ana e Bordit drejtues të BNJVL-së dhe pastaj e pranuar edhe nga Kuvendi gjeneral për avancim të sistemit të vetëqeverisjes lokale në vend. BNJVL-ja dha një propozim – koncept për vazhdim të procesit të decentralizimit, të përcaktuar në tri drejtime: decentralizimi fiskal; zgjerimi i kompetencave të NJVL-ve dhe ndryshime në organizimin e pushtetit lokal. Avancimi më i madh në bisedimet me pushtetin qendror u arrit në pjesën e zgjerimit të kompetencave. Megjithatë, gjendje

одредени политички состојби во земјава овие разговори ги оставија за реализација во следниов период, односно по спроведувањето на вонредните парламентарни избори во земјава. Со цел зголемување на финансиската самостојност на општините, во рамките на ЗЕЛС беше нагласена заложбата сите локални власти да ги зголемат активностите за собирање на сопствените приходи, при што беше покрената и иницијативата за зголемување на стапката на данок на имот, во рамките на законските можности. Од особена важност беше и реафирмирањето на активностите на комисиите при ЗЕЛС. Комисијата за урбанизам и просторно планирање и Управниот одбор на ЗЕЛС посветија поголемо внимание на нацрт-верзија на Предлог-законот за утврдување на правниот статус на бесправно изградените објекти, при што со консензус беше договорено да се стави крај на нелегалното градење, а беа изнесени и низа други предлози. Предмет на дискусија беа и Предлог-законот за урбанистичко планирање, текстот на Нацрт–законот за градење, Правилникот за категоризација на градбите и слично. Забележителна активност во овој период имаше и Мрежата на територијални противпожарни единици (ТППЕ).

„ЗЕЛС тренинг центарот" во текот на минатата година реализира низа обуки, советувања и работилници на кои присуствуваа 881 лице од општинската администрација и општинските совети. ЗЕЛС продолжи и со поддршката на општините во користењето на сите информациски системи. Само преку системот www.gradezna-dozvola.mk, општините издадоа 2.109 одобренија за градење, а преку информацискиот систем www.e-stvari.mk имаше околу 100 објави за аукции. ЗЕЛС реализираше и повеќе проекти за поддршка на локалните власти за спроведувањето на надлежностите и подобрувањето на услугите. Беше реализиран проектот „Поддршка на единиците на локалната власт на РСМ во промоција на одржлива урбана мобилност", а беше обезбедена и поддршка на општините за изработка на документот „функционална анализа". Активностите во областа на родово еднакви општини продолжија преку новиот двегодишен проект, поддржан од UN Women, во чии рамки беше формирана и Лоби група за родова еднаквост на ЗЕЛС. Како партнер во проектот „Зајакнување на општинските совети", ЗЕЛС даде посебен придонес во втората компонента, која се однесува на вмрежувањето на општинските советници. Активната соработка на ЗЕЛС со бројни домашни и странски организации и агенции континуирано се одвиваше и во минатата година.

## Ревизорскиот извештај - потврда за доброто финансиско работење на ЗЕЛС

Извештајот на независна ревизорска куќа за финансиското работење на ЗЕЛС во 2019 година, како втора точка од дневниот ред, беше усвоен со 62 гласа и еден воздржан. Даденото мислење на Ревизорската куќа покажува дека финансиските извештаи во сите материјално значајни аспекти, ја презентираат реално финансиската состојба на Заедницата, како и нејзината финансиска успешност за минатата годината, во согласност со Законот за сметководство на непрофитни организации.

të caktuara politike në vend i lënë këto bisedime për realizim për periudhën e ardhshme, përkatësisht pas zbatimit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në vend. Me qëllim të rritjes së pavarësisë financiare të komunave, në kuadër të BNJVL-së u theksua zotimi që të gjitha autoritetet lokale t'i rrisin aktivitetet për mbledhjen e të ardhurave vetanake, me ç'rast u iniciua edhe iniciativa për rritjen e shkallës së tatimit të pronës, në kuadër të mundësive ligjore. Riafirmimi i aktiviteteve të komisioneve të BNJVL-së ishte me në rëndësi të veçantë. Komisioni i urbanizmit dhe planifikimit hapësinor dhe Bordi drejtues i BNJVL-së i kushtuan një vëmendje më të madhe draft-versionit të Projekt-ligjit për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, me ç'rast me konsensus u ra dakord që t'i vihet fund ndërtimit të paligjshëm, ndërsa u prezantuan edhe një sërë propozimesh të tjera. Objekt i diskutimit ishin edhe Projekt-ligji për planifikim urbanistik, teksti i Draft-ligjit për ndërtim, Rregullorja për kategorizimin e ndërtimeve dhe të tjera. Një aktivitet i dukshëm në këtë periudhë kishte edhe Rrjeti i njësive territoriale të zjarrfikësve (NJTZ-të).

"Qendra e Trajnimeve e BNJVL-së" gjatë vitit të kaluar realizoi një sërë trajnimesh, këshillimesh dhe punëtorish në të cilat morën pjesë 881 persona të administratës komunale dhe këshillave komunalë. BNJVL-ja vazhdoi përkrahjen e komunave në përdorimin e të gjitha sistemeve të informacioneve. Vetëm përmes sistemit www.gradezna-dozvola.mk, komunat lëshuan 2.109 vendime për ndërtim, ndërsa përmes sistemit të informacioneve www.e-stvari.mk kishte rreth 100 shpalljesh për ankande. BNJVL-ja realizoi edhe më shumë projekte për përkrahje të autoriteteve lokale për zbatimin e kompetencave dhe përmirësimin e shërbimeve. U realizua projekti "Mbështetje për njësitë e vetëqeverisjes lokale të RMV-së në promovimin e mobilitetit të qëndrueshëm urban", ndërsa u sigurua edhe mbështetje për komunat për përgatitjen e dokumentit "Analiza funksionale". Aktivitetet në sferën e komunave të barabarta gjinore vazhduan përmes projektit të ri dyvjeçar, të mbështetur nga UN Women, në kuadër të të cilit u formua edhe një grup lobimi për barazi gjinore të BNJVL-së. Si partner në projektin "Përforcimi i këshillave komunalë", BNJVL-ja dha një kontribut të veçantë në komponentin e dytë që ka të bëjë me rrjetëzimin e këshilltarëve komunalë. Bashkëpunimi aktiv i BNJVL-së me organizata dhe agjenci të shumta vendase dhe të huaja u zhvillua në vazhdimësi edhe në vitin e kaluar.

## Raporti i auditimit - konfirmim për punën e mirë financiare të BNJVL-së

Raporti i shtëpisë së pavarur së auditimit për punën financiare të BNJVL-së në vitin 2019, si pikë e dytë e rendit të ditës, u miratua me 62 vota "për" dhe një votë "i përmbajtur". Mendimi i dhënë i shtëpisë së auditimit tregon se raportet financiare në të gjitha aspekte të rëndësishme materiale prezantojnë në mënyrë reale gjendjen financiare të Bashkësisë, si dhe suksesin e saj financiar në vitin e kaluar, në përputhje me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse.

## Општините сè повеќе посветени кон редовно плаќање на членарината

Управниот одбор ја разгледа и завршната сметка на ЗЕЛС за 2019 година, каде е даден соодветен приказ на приходите и на расходите на Заедницата за претходната година. Од Управниот одбор на ЗЕЛС беа упатени пофални зборови за рационалното користење на приходите, а со сите гласови за усвојување на овој документ, истото го потврдија и делегатите на Генералното собрание на ЗЕЛС. Всушност, минатата година се смета за финансиски успешна година за ЗЕЛС, од аспект на реализација на обврските на незините членки за плаќање на членарината, што е многу значаен фактор за јакнење на финансиската самоодржливост на Заедницата. Потврда за тоа се бројките на приходите од членарината кои учествуваат со 86,5% во вкупните приходи на ЗЕЛС, а приходите од донација се со учество од само 9,2 %. Всушност, повеќе општини со блокирани сметки и високи долгови, кои добија средства за покривање на половина од евидентираните долгови што ги доставиле до Министерството за финансии, ја искористија оваа можност и за исплата на долгот кон ЗЕЛС, по основ на членарина. Во однос на структурата на трошоци, поединечно беа прикажани трошоците за активностите за лобирање; за поддршка на органите и телата на ЗЕЛС; за обуки и логистика; печатење и информирање и за ЗЕЛС единицата за поддршка на електронските услуги - ЗЕПЕ (е-системи, софтвер, хардвер и одржување). Во пристигнатите изјави немаше предлози од делегатите за дополнителни точки на дневниот ред, ниту пак, беа доставени дополнителни иницијативи за лобирање.

## Komunat gjithnjë e më shumë të përkushtuara për pagesën e rregullt të anëtarësisë

Bordi drejtues shqyrtoi edhe llogarinë përfundimtare të BNJVL-së për vitin 2019, ku është dhënë një pasqyrë përkatëse e të ardhurave dhe të dalave të Bashkësisë për vitin e mëparshëm. Nga Bordi drejtues i BNJVL-së u dhanë fjalë lavdërimi për përdorimin racional të të ardhurave, ndërsa me të gjitha votat "për" miratimin e këtij dokumenti, të njëjtën gjë e konfirmuan edhe delegatët e Kuvendit gjeneral të BNJVL-së. Në fakt, viti i kaluar konsiderohet për një vit të suksesshëm financiar të BNJVL-së nga aspekti i realizimit të obligimeve të anëtareve të saja për pagesën e anëtarësisë, që është një faktor shumë i rëndësishëm për forcimin e vetë-qëndrueshmërisë financiare të Bashkësisë. Konfirmim për këtë janë numrat e të ardhurave të anëtarësisë që marrin pjesë me 86.5% në të ardhurat totale të BNJVL-së, ndërsa të ardhurat e donacioneve janë me një pjesëmarrje prej vetëm 9.2%. Në fakt, më shumë komuna me llogari të bllokuara dhe borxhe të mëdha, të cilat morën mjete për t'i shlyer gjysmën e borxheve të evidentuara që i kanë dërguar në Ministrinë e Financave, shfrytëzuan këtë mundësi për të paguar borxhin ndaj BNJVL-së në bazë të anëtarësisë. Sa i përket strukturës së shpenzimeve, u treguan në mënyrë individuale shpenzimet për aktivitetet e lobimit; për mbështetjen e organeve dhe trupave të BNJVL-së; për trajnime dhe logjistikë; shtypje e informim dhe për njësinë e BNJVL-së për mbështetje të shërbimeve elektronike – ZEPE (e-sisteme, softuer, harduer dhe mirëmbajtje). Në deklaratat e dërguara nuk kishte propozime të delegatëve për pika shtesë të rendit të ditës, e as që u dërguan iniciativa shtesë për lobim.

## ПРЕЗЕНТИРАНА „АНАЛИЗА НА СОСТОЈБИТЕ, ПРАВНИТЕ АСПЕКТИ И ФИНАНСИСКАТА ОДРЖЛИВОСТ СО ДЕТАЛЕН ПЛАН ЗА ПРЕНОС НА НАДЛЕЖНОСТИТЕ И РЕСУРСИТЕ ОД ЦЕНТРАЛНО НА ЛОКАЛНО НИВО ВО ОБЛАСТА НА ЗЕМЈОДЕЛСТВОТО"

## ËSHTË PREZANTUAR "ANALIZA E GJENDJEVE, ASPEKTEVE JURIDIKE DHE QËNDRUESHMËRISË FINANCIARE ME PLAN TË DETAJUAR PËR TRANSFERIM TË KOMPETENCAVE DHE RESURSEVE NGA NIVELI QENDROR NË ATË LOKAL NË SFERËN E BUJQËSISË"

Активностите за унапредување на системот на локалната власт, што ЗЕЛС ги иницираше минатата година, кога беа организирани и низа разговори со Владата на РСМ, повторно стануваат актуелни. Во утврдениот предлог–концепт за продолжување на процесот на децентрализацијата, постигнат минатата година, Министерството за земјоделство, шумарство и водостопанство (МЗШВ) покажа подготвеност за префрлање на повеќе надлежности на локално ниво, меѓу кои: правото на управување со земјоделското земјиште; со шумите и со пасиштата, а понуди и свои дополнителни предлози. Во таа насока, за потребите на проектот „Подобрување на управувањето со општините" спроведуван од страна на Програмата за развој на Обединетите нации (УНДП) во соработка со Министерство за локална самоуправа и Министерство за финансии, а финансиран од Европската Унија, обезбедена е анализа за импликациите што овој процес на децентрализација, во оваа област, може ги предизвика кај единиците на локалната самоуправа (ЕЛС).

Aktivitetet për avancimin e sistemit të pushtetit lokal, të cilat i inicioi BNJVL-ja vitin e kaluar kur u organizuan edhe një sërë bisedimesh me Qeverinë e RMV-së, serish bëhen aktuale. Në propozim-konceptin e definuar për vazhdimin e procesit të decentralizimit, të arritur në vitin e kaluar, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) tregoi gatishmërinë e saj për transferim të më shumë kompetencave në nivel lokal, ndër të cilat: e drejta për menaxhim të tokës bujqësore, të pyjeve dhe kullotave dhe ofroi edhe propozime të veta shtesë. Në këtë drejtim, për nevojën e projektit "Përmirësimi i qeverisjes së komunave" që zbatohet nga ana e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministrinë e Financave, e financohet nga Bashkimi Evropian, është siguruar një analizë për implikimet të cilat ky proces i decentralizimit, në këtë sferë, mund t'i shkaktojë te njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL).

**Околу 50% од општините, генерално руралните, би имале дополнителни приходи ако закупот на државно земјоделско земјиште е под локална надлежност**

„Анализа на состојбите, правните аспекти и финансиската одржливост со детален план за пренос на надлежностите и ресурсите од централно на локално ниво во областа на земјоделството" е насловот на експертскиот извештај чии наоди и заклучоци беа тема на онлајн работилницата, што се одржа на 1 јули, 2020 година. Извештајот беше презентиран пред претставниците од ЗЕЛС: градоначалникот на Општина Велес и член на Мешовитата работна група за унапредување на системот на локалната власт; градоначалникот на Општина Конче, Благој Илиев, претседател на Комисијата за рурален развој при ЗЕЛС и извршната директорка на ЗЕЛС, Душица Перишиќ, како и пред претставници од МЗШВ и од УНДП. Експертите посочија дека, според добиените инструкции, посебно внимание посветиле на импликациите при пренесувањето на надлежностите од подрачните единици на МЗШВ на општините. Тие укажаа на актуелните состојби во подрачните единици, нивниот правен статус, ингеренциите што ги имаат, ресурсите со кои располагаат (човечки и материјални), законите со кои е опфатено нивното работење. Притоа, посочија на правните недостатоци и празнини за уредување на одредени активности, на слабостите во воспоставувањето на квалитетна употреба на информатичко–комуникациски технологии во водењето на регистрите и комуникацијата со други институции и на потребата од зајакнување на административните капацитети. Во однос на финансиските импликации за општините од префрлањето на оваа надлежност на локално ниво, изработени се пет сценарија кои генерално покажуваат дека 50% од општините, особено руралните, би имале придобивки, односно би оствариле дополнителни приходи од закупот на државното земјоделско земјиште. Беа посочени и слабостите во тековната наплата, што значително би можела да се подобри доколку општините управуваат со ова земјиште.

**Локалната власт бара вистинска децентрализација и во областа на земјоделството**

Претседателот на Комисијата за рурален развој при ЗЕЛС, градоначалникот на Општина Конче, Благој Илиев, даде позитивна оценка за анализата, истакнувајќи дека таа ја отсликува реалната состојба и дека е во насока на обезбедување на поквалитетни услуги за граѓаните и дополнителни приходи за општините. Илиев особено го истакна моментот на непосредната поддршка што општината може да им ја даде на своите граѓани, бидејќи тие и сега и се обраќаат на општинската администрација за помош при остварувањето на нивните права и обврски, пред да се обратат во подрачната единица. Исто така, тој посочи дека локалната власт ќе има поголем увид како се управува со закупеното земјиште, како тече исплатата и ќе оствари поголем прилив на приходи. Градоначалникот укажа дека е потребно добро да се прецизира законската регулатива во однос на ингеренциите на општината и на инспекциските служби, како и да се обезбеди подобра комуникацијата со централните институции, особено при

**Rreth 50% të komunave, në përgjithësi ato rurale do të kishin të ardhura shtesë nëse dhënia me qira e tokës shtetërore bujqësore është nën kompetencën lokale**

"Analiza e gjendjeve, aspekteve juridike dhe qëndrueshmërisë financiare me plan të detajuar për transferim të kompetencave dhe resurseve nga niveli qendror në atë lokal në sferën e bujqësisë" është titulli i raportit të ekspertëve, gjetjet dhe përfundimet e të cilit ishin temë e punëtorisë online që u mbajt më 1 qershor 2020. Raporti u prezantua para përfaqësuesve të BNJVL-së, kryetarit të Komunës së Velesit dhe anëtar të grupit të përzier punues për avancim të sistemit të pushtetit lokal, kryetarit të Komunës së Konçes, Bllagoj Iliev, kryetar i Komisionit të zhvillimit rural të BNJVL-së dhe drejtoreshës ekzekutive të BNJVL-së, Dushica Perishiq, si dhe para përfaqësuesve të MBPEU-së dhe UNDP-së. Ekspertët theksuan se, sipas instruksioneve të marra, një vëmendje të veçantë u kanë kushtuar implikimeve gjatë transferimit të kompetencave nga njësitë rajonale të MBPEU-së ndaj komunave. Ata theksuan gjendjet aktuale në njësitë rajonale, statusin e tyre juridik, kompetencat që i kanë, resurset të cilat i kanë në dispozicion (njerëzore dhe materiale), ligjet me të cilat është përfshirë puna e tyre. Njëkohësisht, ata theksuan mungesat dhe zbrazëtirat juridike për rregullimin e aktiviteteve të caktuara, dobësitë në vendosjen e përdorimit cilësor të teknologjive informatike – komunikuese në udhëheqjen e regjistrave dhe komunikimit me institucionet e tjera dhe nevojën për forcimin e kapaciteteve administrative. Në raport me implikimet financiare të komunave nga transferimi i kësaj kompetence në nivel lokal janë përgatitur pesë skenarë, të cilët tregojnë në përgjithësi se 50% e komunave, sidomos ato rurale, do të kishin përfitime, përkatësisht do të realizonin të ardhura shtesë nga dhënia me qira e tokës shtetërore bujqësore. U theksuan edhe dobësitë gjatë arkëtimit aktual të mjeteve, që do të mund të përmirësohej në mënyrë të konsiderueshme nëse komunat menaxhojnë me këtë tokë.

**Pushteti lokal kërkon decentralizim të vërtetë edhe në sferën e bujqësisë**

Kryetari i Komisionit të zhvillimit rural pranë BNJVL-së, kryetar i Komunës së Konçes, Bllagoj Iliev dha vlerësim pozitiv për analizën duke theksuar se reflekton gjendjen reale dhe se është në drejtim të sigurimit të shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe të ardhurave shtesë për komunat. Iliev sidomos theksoi momentin e mbështetjes së drejtpërdrejtë që mund t'ua japë komuna qytetarëve të saj, sepse ata edhe tani i drejtohen administratës komunale për ndihmë në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre para se të drejtohen në njësinë rajonale. Ai gjithashtu theksoi se pushteti lokal do të ketë një pasqyrë më të madhe se si menaxhohet me tokën e dhënë me qira, se si zhvillohet pagesa dhe do të realizojë një fluks më të madh të të ardhurave. Kryetari i komunës tha se është e nevojshme që të precizohet mirë rregullorja ligjore në raport me kompetencat e komunës dhe shërbimeve të inspektimit, si dhe të sigurohet një komunikim më të mirë me institucionet qendrore, sidomos gjatë shndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

пренаменувањето на земјоделското во градежно земјиште. Претставниците од МЗШВ посочија дека во однос на постапката за пренаменување на земјоделско земјиште во градежно, тие само даваат мислење дали земјиштето е под закуп или има друг статус, а ингеренции се во Министерството за транспорт и врски. Исто така, тие посочија дека во оваа фаза, според нивните последни сознанија, нема расположение за децентрализирање во делот на продажбата на државното земјоделско земјиште и на управувањето со шумите и со пасиштата.

Голема разочараност од атерирањето на ставот на МЗШВ, изрази градоначалникот Аце Коцевски. Тој посочи дека токму ова Министерство за земјоделство шумарство и водостопанство во минатогодишните разговори во Мешовитата работна група, составена од тројца претставници од локалната власт и тројца од Владата на РСМ, покажало најголем ентузијазам за префрлање на голем број надлежности од доменот на своето работење, на локално ниво, особено во делот на префрлање на ингеренциите за продажбата на државно земјоделско земјиште, управувањето со шумите и со пасиштата. Коцевски посочи дека во анализата ја очекувал разработката и на овие сегменти, а не само на префрлањето на „технички" ингеренции од подрачните единици на МЗШВ, на општините. Беше нагласено дека во следниов период, преку Мешовитата работна група ќе се преиспита овој став на МЗШВ, особено што во документот за продолжување на процесот на децентрализацијата што во втората половина на месец октомври го добија членовите на оваа работна група, јасно е наведено расположението за префрлање на поголеми надлежности на локално ниво во областа на земјоделството. На крајот од работилницата, Коцевски го повтори ставот на ЗЕЛС дека е потребно вистинско продлабочување на процесот на децентрализација и во оваа област, што ќе биде проследен со адекватни финансиски средства за спроведување на префрлените надлежности.

Përfaqësuesit e MBPEU-së theksuan se në raport me procedurën për shndërrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ata vetëm japim mendime nëse toka është e dhënë me qira ose ka një status tjetër, ndërsa kompetencat janë në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Ata po ashtu theksuan se në këtë fazë, sipas informacioneve të tyre të fundit, nuk ka dispunim për decentralizim në pjesën e shitjes së tokës bujqësore dhe menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.

Një dëshpërim të madh për ndryshimin e qëndrimit të MBPEU-së shprehu kryetari i Komunës së Velesit, Ace Kocevski. Ai theksoi se pikërisht kjo Ministri e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në bisedimet e vitit të kaluar me grupin e përzier punues, të përbërë nga tre përfaqësues të pushtetit lokal dhe tre përfaqësues të Qeverisë së RMV-së, ka treguar një entuziazëm më të madh për transferim të numrit më të madh të kompetencave të domenit të punës së saj në nivel lokal. Sidomos në pjesën e transferimit të kompetencave për shitjen e tokës shtetërore bujqësore, menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Kocevski theksoi se në analizën e ka pritur përpunimin edhe të këtyre segmenteve, e jo vetëm të transferimit të kompetencave "teknike" nga njësitë rajonale të MBPEU-së ndaj komunave. U theksua se në periudhën e ardhshme, përmes grupit të përzier punues do të rishqyrtohet ky qëndrim i MBPEU-së, sidomos që në dokumentin për vazhdimin e procesit të decentralizimit, të cilin e morën anëtarët e këtij grupi punues në gjysmën e dytë të muajit tetor, është specifikuar qartë dispunimi për transferimin e kompetencave më të mëdha në nivel lokal në sferën e bujqësisë. Në fund të punëtorisë, Kocevski përsëriti qëndrimin e BNJVL-së se ka nevojë për një thellim të vërtetë të procesit të decentralizimit edhe në këtë sferë, që do të shoqërohet me mjete adekuate financiare për zbatim të kompetencave të transferuara.





ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT




**КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ**
тел. +389 (0)2 30 99 033 | факс: +389 (0)2 30 61 994
ул. "Копенхагенска" бр. 5, п. фах 32, 1000 Скопје, Република Северна Македонија
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

**INFORMACIONE PËR KONTAKT:**
tel. +389 (0)2 30 99 033 | faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. "Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk